

VENDIM
Nr. 32, datë 27.10.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare
Elsa Toska	anëtare
Marsida Xhaferllari	anëtare
Altin Binaj	anëtar
Përparim Kalo	anëtar
Sonila Bejtja	anëtare
Fiona Papajorgji	anëtare

me sekretare Enina Kotoni, në datat 14.10.2021 dhe 20.10.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 1 (U) 2021 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQATA “UNIONI I NOTERËVE SHQIPTARË”, përfaqësuar nga kryetari i shoqatës, Admir Drago dhe av. Bledar Fejzo, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Mimoza Arbi.

KËSHILLI I MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Besmir Beja dhe Embro Ahmetaj.

MINISTRIA E DREJTËSISË, përfaqësuar me autorizim nga Besmir Beja.

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË, përfaqësuar me autorizim nga av. Arben Hakani.

OBJEKTI: Shfuqizimi i pikës 2, të nenit 8, pikës 6, të nenit 10, pikës 4, të nenit 15, shkronjave “d” dhe “dh”, të pikës 2, të nenit 26, pikës 5, të nenit 26, shkronjave “ç” dhe “d”, të nenit 27, pikës 2, të nenit 31, neneve 41–53, shkronjës “ll”, të pikës 1, të nenit 63, fjalisë “*Paga e zëvendësnoterit nuk mund të jetë më e ulët se 150 % e pagës minimale mujore në shkallë vendi, sipas legjislacionit në fuqi*” në pikën 2 të nenit 75, shkronjave “dh” dhe “gj”, të nenit 81, nenit 95, nenit 96, togfjalëshit “*identifikuesin elektronik të aktit*” në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 105, si dhe të fjalisë “*Çdo akt dhe veprim noterial merr nga sistemi elektronik një numër unik elektronik*” në nenin 106 të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1045, datë 15.1.2020, “Për mënyrën e ndërldhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të shkronjave “d” dhe “dh”, të pikës 2, të nenit 26, si dhe të neneve 41–53, 95, 96 dhe 106, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, dhe të vendimit nr. 1045, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 18, 49, 52, pika 1, 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28, 29, 30, 45 dhe 49 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, shoqatës “Unioni i Noterëve Shqiptarë” (*UNSH*), e cila kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*), Ministrisë së Drejtësisë, të cilat kërkuan rrëzimin e

kërkesës, si dhe të subjektit të interesuar, Dhomës Kombëtare së Noterisë (DHKN), që kërkojnë rrëzimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi në datën 20.12.2018 ka miratuar ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë” (*ligji nr. 110/2018*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 16, datë 13.2.2019.

2. Ligji nr. 110/2018 ka si objekt përcaktimin e rregullave për ushtrimin e profesionit të noterit, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit të noterisë dhe për qëllim garantimin e këtij shërbimi, si dhe ushtrimin e profesionit të noterit në mënyrë të pavarur dhe në mbështetje të ligjit.

3. Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 1045, datë 15.1.2020 “Për mënyrën e ndërlidhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave” (*VKM nr. 1045/2020*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 17, datë 4.2.2021. VKM-ja parashikon ndërlidhjen e sistemit elektronik të DHKN-së me Regjistrin Kombëtar të Zyrës së Gjendjes Civile, Regjistrin Publik të Pasurive të Paluajtshme, Regjistrin e Barrëve Siguruese, Regjistrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe me sistemet informatike të agjencive shtetërore/publike ose private, si dhe me sistemin bankar, me qëllim tërheqjen e informacionit të nevojshëm për hartimin e aktit dhe veprimit noterial.

4. Kërkuesja, shoqata “Unioni i Noterëve Shqiptarë” (*kërkuesja*), në datën 27.2.2021, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin si të pajtueshme me Kushtetutën të disa prej dispozitave të ligjit nr. 110/2018 dhe të VKM-së nr. 1045/2020, si dhe pezullimin e zbatimit të tyre sipas objektit të kërkesës.

5. Kolegji i Gjykatës në datën 23.4.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 11.5.2021 ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare publike. Për sa i përket kërkesës për pezullim, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur shqyrtimin e saj në seancë plenare publike.

6. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, gjatë seancës plenare ka paraqitur kërkesë paraprake me objekt përjashtimin e një anëtari të kësaj Gjykate nga shqyrtimi i çështjes, me pretendimin se ndodhet në kushtet e nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000.

7. Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën konstatoi se një prej shkaqeve të parashtruara për përjashtimin e gjyqtarit është i njëjtë me atë të paraqitur nga vetë gjyqtari në kërkesën për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, e cila u rrëzua nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin e datës 21.4.2021. Për sa i përket shkakut tjetër të pretenduar nga subjekti i interesuar, Gjykata çmoi se anëtari nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000, si dhe mbështetur edhe në pikën 2 të po këtij neni vendosi rrëzimin e kërkesës për përjashtimin.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. Kërkuesja ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

8.1 UNSH-ja *legjitimohet* në kërkesën e saj, pasi është person juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 3861, datë 14.5.2014. Ligji nr. 110/2018 dhe VKM-ja nr. 1045/2020 sjellin efekte të drejtpërdrejta për noterët, sepse ndikojnë në mënyrën e ushtrimit të këtij profesioni, prandaj ekziston lidhja midis objektit të veprimtarisë së kërkueses dhe çështjes objekt shqyrtimi.

8.2 *Për kërkesën për pezullim*

8.2.1 *Për ligjin nr. 110/2018*: Zbatimi i shkronjave “d” dhe “dh” të pikës 2 të nenit 26 dhe i neneve 41-53, 95, 96 dhe 106 të ligjit nr. 110/2018, sjell cenim të lirisë ekonomike dhe të mbrojtjes së të dhënave personale të një grupi profesionistësh, siç janë noterët, të cilët duhet t'i përpilojnë aktet noteriale, t'i nënshkruajnë elektronikisht dhe t'i regjistrojnë ato në dy sisteme, në bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrat Noterial Shqiptar (RNSH), edhe në sistemin elektronik të DHKN-së (NISA). Kjo sjell tarifa dhe kosto të papërcaktuara në ligj dhe të paqarta për mënyrën se si do të përcaktohen për noterët, e, për rrjedhojë, një taksë të fshehur, pa autorizim nga ligji. Krijimi i një bordi disiplinor (nenet 41-53) do të bëjë të pamundur rifitimin në kohë të arsyeshme të të drejtave të noterëve në rast se do të merren vendime nga ky bord, sipas procedurave të parashikuara në ligj.

8.2.2 *Për VKM-në nr. 1045/2020*: Ndërlidhjet që parashikon ky vendim noteri i siguron pa asnjë kosto shtesë nëpërmjet sistemit *e-Albania* dhe ndërlidhjes së siguruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) të kryefaqja. Sistemi NISA në praktikë kërkon një investim të ri në pajisje, në burime njerëzore, sepse përpilimi i një akti zgjatet dukshëm në kohë dhe hedhja e të dhënave në këto dy sisteme, NISA dhe RNSH, është haptazi në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të ndryshuar (*ligji nr. 10325/2010*) dhe nenin 7 të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar (*ligji nr. 9880/2008*).

8.3 *Për themelin e kërkesës*

8.3.1 *Ligji nr. 110/2018 cenon:*

8.3.1.1 *Parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit*, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi pika 2 e nenit 8 dhe pika 4 e nenit 15 të ligjit nr. 110/2018, duke parashikuar respektivisht se kandidati për noter nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt i shkallës së dytë me noterin pranë të cilit do të punojë dhe se zëvendësnoteri nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt i shkallës së dytë i noterit pranë të cilit do të emërohet, u mohojnë bashkëshortit dhe fëmijëve të noterëve të drejtën të konkurrojnë në mënyrë të barabartë me të gjithë shtetasit e tjerë për të marrë licencën e noterit. Parashikimi ligjor bie ndesh edhe me *nenin 49 të Kushtetutës*, sepse nuk lejon që bashkëshorti dhe fëmijët e noterëve të ushtrojnë profesionin në vendin ku dëshirojnë.

8.3.1.2 *Të drejtën për të mos kryer një punë të detyruar*, të parashikuar nga neni 26 i Kushtetutës dhe nga neni 4 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), pasi parashikimi në pikën 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 detyron noterin të kryejë shërbimit disaditor në një bashki tjetër, brenda të njëjtut rreth gjyqësor, në të cilën nuk vepron asnjë zyrë noteriale. Gjithashtu, ky parashikim bie ndesh edhe me *lirinë e veprimtarisë private dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës*. Në këtë rast duhet të merret të paktën edhe pëlqimi i noterit.

8.3.1.3 *Të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale*, të parashikuar nga neni 35 i Kushtetutës, pasi ligji nr. 110/2018 ka përcaktuar krijimin dhe përdorimin e sistemit NISA, duke anashkaluar standardet ligjore dhe ndërkombëtare të gjithëpranuara të krijimit të bazave shtetërore të të dhënave. Detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 10325/2010 në asnjë rast nuk përjashtojnë detyrimet që burojnë nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (*ligji nr. 9887/2008*). Aktualisht ka dy sisteme dhe ligji nr. 10325/2010 ndalon krijimin e bazave të të dhënave shtetërore të veçanta për njëtin informacion ose qëllim (pika 3 e nenit 4).

8.3.1.4 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi pikat 2 dhe 5 të nenit 26 (*masat disiplinore me vendim të Bordit Disiplinor*), nenet 41-53 (*masat disiplinore dhe procedurat disiplinore*), shkronja “ll” e pikës 1 të nenit 63 (*detyrat e noterit*), shkronjat “dh” dhe “gj” të nenit 81 (*veprimtaria e Dhomës Kombëtare të Noterisë*), neni 95 (*dokumentet elektronike*), neni 96 (*qasja dhe aplikimi nëpërmjet sistemit elektronik në regjistrat elektronikë publikë*), neni 105 (*përmbajtja e aktit noterial*) dhe neni 106 (*regjistrimi i akteve dhe veprimeve noteriale*) të ligjit nr. 110/2018 cenojnë interesat e noterëve, të cilët duhet të paguajnë tarifa dhe kosto të papërcaktuara në ligj dhe të paqarta për mënyrën se si do të përcaktohen. Gjithashtu, nenet 63, 81, 96, 105 dhe 106 të ligjit nr. 110/2018 janë në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 10325/2010, ndërsa neni 95 i ligjit nr. 110/2018 bie në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9880/2008.

8.3.1.5 *Parimin e hierarkisë së veprimtarisë së organeve shtetërore*, sepse pavarësisht se në nenin 3 të ligjit nr. 110/2018 parashikohet se noteri licencohet nga ministri i Drejtësisë, sipas pikave 2 dhe 5 të nenit 26 të këtij ligji, kompetencën për ta pezulluar nga detyra dhe për t'i hequr licencën e ka Bordi Disiplinor. Gjithashtu, konstatohet një mungesë e koherencës së ligjit midis këtyre parashikimeve dhe shkronjës “e” të nenit 21 të ligjit. Edhe shkronja “a” e nenit 28 të ligjit nr. 110/2018, duke parashikuar që në përfundim të hetimit disiplinor ministri i Drejtësisë i paraqet Bordit Disiplinor raportin e hetimit, i atribuon këtij të fundit kompetenca për të vendosur për fillimin ose jo të procedimit disiplinor, ndërkohë që në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8678/2001) procedimi disiplinor është kompetencë e ministrit të Drejtësisë. Krijimi i Bordit Disiplinor dhe dispozitat që rregullojnë procedurat disiplinore (nenet 41-53 të ligjit nr. 110/2018) bien ndesh me nenin 21 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) dhe me dispozitat e ligjit nr. 8678/2001.

8.3.1.6 *Parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore*, të parashikuara në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” (ligji nr. 90/2012), pasi Bordi Disiplinor është organ i DHKN-së, por për shkak të mungesës së harmonisë në ligj, ai, nga njëra anë, ka në përbërjen e tij anëtarë të zgjedhur nga ministri i Drejtësisë dhe, nga ana tjetër, në përfundim të procedimit disiplinor merr vendimet më të rëndësishme që ndikojnë në veprimtarinë profesionale të noterit.

8.3.1.7. Nenin 358 të Kodit Civil (KC) dhe nenet 76, 90 dhe 103 të Kodit të Familjes (KF), pasi neni 127 i ligjit, i cili parashikon procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nën regjimin pasuror martesor, ka ndërhyrë në regjimin martesor në bashkësi dhe atë të kërimit të trashëgimisë, që rregullohen nga këto kode.

8.3.1.8 *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, të parashikuar në nenin 30 të Kushtetutës, pasi veprimet ose mosveprimet e kryera nga noteri, që përbëjnë vepër penale, janë vetëm kompetencë e gjyqësorit dhe jo e Bordit Disiplinor, sikurse parashikohet në fjalinë e fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018.

8.3.1.9 *Të drejtën për dëmshpërblim*, të parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi duke qenë se Bordi Disiplinor mbështetet administrativisht nga DHKN-ja dhe fondet e kësaj të fundit krijohen nga kuotat dhe pagesa të tjera të kryera nga noterët, në rast kundërshtimi të një vendimi të padrejtë të marrë nga Bordi Disiplinor, noterët do të detyroheshin të dëmshpërblenin noterin e dëmtuar. Në këto kushte, një noter i dëmtuar nga një vendim i Bordit Disiplinor nuk mund të pretendojë të drejtën e tij kushtetuese për dëmshpërblim, por do të ishte ndryshe nëse vendimarrja do të ishte në kompetencë të ministrit të Drejtësisë.

8.3.1.10 *Kriterin e përcaktimit me ligj të sistemit të sigurimeve shoqërore*, të parashikuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi pika 2 e nenit 75 të ligjit nr. 110/2018, duke parashikuar pagën minimale mujore të zëvendësnoterit, ndikon në sistemin e sigurimeve shoqërore, pavarësisht se dispozita kushtetuese nuk lejon që sistemi i pagesës së këtyre kontributeve të përshkallëzohet me ligj të veçantë.

8.3.1.11 *Detyrimin për të shoqëruar ligjin me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij*, sipas parashikimit të nenit 82 të Kushtetutës. Zbatimi i ligjit nr. 110/2018 do të ngarkojë me kosto të larta noterin, pasi ai do të taksohet në mënyrë të dyfishtë si nga shteti, ashtu edhe nga DHKN-ja. Në ligj nuk ka asnjë organ shtetëror, i cili do të ushtrojë kontroll mbi përcaktimin dhe destinacionin e shumave që do t'u merren noterëve në formën e kuotës ose pagesave për sistemin NISA.

8.3.1.12 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, pasi ligji i kundërshtuar nuk siguron garancitë procedurale në rastin kur procedimi disiplinor përfundon me marrjen e masës disiplinore të pezullimit ose të heqjes së licencës së noterit, sepse ankimi në gjykatë, sipas nenit 52 të ligjit nr. 110/2018, nuk pezullon zbatimin e vendimit të Bordit Disiplinor.

8.3.2 *VKM-ja nr. 1045/2020 cenon:*

8.3.2.1 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi parashikimet e saj bien ndesh me ligjin nr. 9880/2008, i cili përcakton se nënshkrimi elektronik nuk mund të përdoret në veprimet juridike në fushat e së

drejtës familjare dhe të së drejtës së trashëgimisë, si dhe në veprime të tjera juridike, të cilat kërkojnë legalizim publik, një akt noterial ose një autorizim nga gjykata. Gjithashtu, VKM-ja nr. 1045/2020 është miratuar në datën 15.1.2020 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 4.2.2021, pra pas një viti. Ndërkohë, kanë dalë urdhra të ministrit të Drejtësisë që rregullojnë aspekte të funksionimit të sistemit përpara hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 1045/2020, që ka ligjëruar këtë bazë të dhënash.

8.3.2.2 *Mbrojtjen e të dhënave personale*, pasi sistemi është krijuar dhe miratuar vetëm në bazë të pikës 3 të nenit 96 të ligjit nr. 110/2018 dhe jo sipas *lex specialis*, ligjit nr. 10325/2010, që rregullon bazat e të dhënave shtetërore. DHKN-ja, si institucioni administrues i të dhënave, nuk legjitimohet në këtë funksion, pasi të dhënat shtetërore duhet të administrohen nga një person publik ose privat që ushtron funksione publike (shkronja “b”, pika 1, e nenit 2 të ligjit nr. 10325/2010) dhe DHKN-ja nuk ushtron funksion publik. Aktet noteriale përpilohen nga një sistem elektronik “anonim” për Agjencinë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit (AKSHI), që është autoriteti përgjegjës për miratimin e sistemeve të bazave të të dhënave shtetërore dhe përmbajnë në faqen e parë *barcode* që nuk gjenerojnë asnjë informacion.

8.3.2.3 *Interesat e noterëve*, pasi ajo prezanton kosto shtesë për ata dhe rrjedhimisht një taksë të fshehur, e cila ndikon në *parimin e lirisë ekonomike* dhe në sistemin tatimor. Noterët duhet të përpilojnë aktet noteriale, të nënshkruajnë elektronikisht, të regjistrojnë aktet noteriale në sistemin NISA, si dhe të paguajnë tarifa dhe kosto të papërcaktuara në ligj dhe të paqarta për mënyrën se si do të përcaktohen. Ndërkohë që ekziston sistemi elektronik RNSH, i miratuar me VKM-në nr. 304, datë 21.5.2014 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar” (VKM nr. 304/2014), ku veprimet noteriale kryhen pa asnjë tarifë shtesë. Të gjitha ndërldhjet që parashikon VKM-ja nr. 1045/2020, noteri i siguron pa kosto nëpërmjet sistemit *e-Albania* dhe ndërldhjes së siguruar nga ASHK-ja te kryefaqja.

9. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

9.1 Kërkesja *nuk legjitimohet* në aspektin material për pretendimet se disa dispozita cenojnë parimet e hierarkisë së normave, e hierarkisë së veprimtarisë së organeve shtetërore dhe sigurinë juridike. Ato qëndrojnë jashtë juridiksionit kushtetues, pasi kanë të bëjnë me përplasjen ndërmjet ligjeve.

9.2 Kërkesa për *pezullimin* e zbatimit të ligjit dhe VKM-së është e pabazuar, pasi kërkesja nuk ka paraqitur argumente konkrete dhe reale për rrezikun dhe pasojat e mundshme që vijnë nga zbatimi i këtyre akteve, si dhe nëse ato prekin interesat e saj.

9.3 *Për themelin e kërkesës*

9.3.1 *Për ligjin nr. 110/2018*

9.3.1.1 Ligji nuk bie ndesh me *nenet 18 dhe 49 të Kushtetutës*, pasi ai synon një proces të pranimit në formimin fillestar bazuar në parimin e meritokracisë dhe barazisë para ligjit, duke shmangur çdo ndikim politik, miqësor, nepotik ose trashëgiminë e profesionit, si dhe duke parandaluar abuzimet dhe korrupsionin në licencim. Gjithashtu, pika 2 e nenit 8 dhe pika 4 e nenit 15 të ligjit nuk cenojnë të drejtën e bashkëshortëve ose të të afërmeve të noterëve për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme dhe për të zgjedhur profesionin e tyre.

9.3.1.2 Pretendimi *për cenimin e nenit 26 të Kushtetutës dhe nenit 4 të KEDNJ-së* është i pabazuar. Parashikimi në pikën 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 për kryerjen e shërbimit në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor, në të cilin nuk vepron asnjë zyrë noteriale, *nuk cenon parimet e lirisë së veprimtarisë private dhe lirisë ekonomike të noterëve*, pasi shërbimi në një bashki tjetër nuk është me detyrim dhe ka si qëllim dhënien e ndihmës komunitetit ku nuk ka zyrë të shërbimit noterial. Ky parashikim ligjor nuk bie në kundërshtim as me *nenin 49 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për të zgjedhur vendin e punës*. Ligjvënësi ka detyrimin që përmes normave të miratuara prej tij të garantojë edhe parimin e shtetit social dhe të së mirës së përbashkët, duke pasur parasysh karakterin publik të profesionit të noterit.

9.3.1.3 *Parimet e sigurisë juridike dhe të hierarkisë së veprimtarisë së organeve shtetërore* nuk cenohen, pasi ligji nr. 110/2018 përmban rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen nga noteri në kryerjen e

akteve dhe veprimeve specifike noteriale. Ndërsa në nenin 95 të këtij ligji parashikohet nënshkrimi elektronik vetëm për dokumentet e vërtetuara dhe jo për veprime të mirëfillta juridike, për të cilat legjislacioni në fuqi kërkon akt noterial si kusht për vlefshmërinë e tyre.

9.3.1.4 *E drejta për dëmshpërblim*, e parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, nuk cenohet, pasi ligji në asnjë dispozitë nuk përjashton të drejtën e noterëve ose zëvendësnoterëve për të kërkuar dëmshpërblim në rast të një vendimi të padrejtë të marrë nga Bordi Disiplinor. Kërkesja nuk ka parashtruar asnjë argument kushtetues që të provojë se nëse vendimmarrja do të ishte kompetencë e ministrit të Drejtësisë dhe jo e Bordit Disiplinor do të garantohej e drejta kushtetuese për të kërkuar dëmshpërblim.

9.3.1.5 *Neni 82 i Kushtetutës* nuk cenohet, pasi sistemi NISA është krijuar dhe funksionon brenda DHKN-së, e cila vendos edhe për kostot ose mënyrën e mirëmbajtjes së tij. Për këtë arsye ligjvënësi nuk ka pasur arsye të kërkojë koston financiare për ligjin në fjalë, duke qenë se neni 82 i Kushtetutës vendos detyrim për shpenzimet financiare që ndikojnë drejtpërdrejt në buxhetin e shtetit.

9.3.1.6 *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, si pasojë e mospezullimit të ekzekutimit të vendimit të Bordit Disiplinor për pezullimin ose heqjen e licencës së noterit në rast të ankimit ndaj këtij vendimi në gjykatë, nuk cenohet, pasi në këtë rast gjen zbatim parimi se akti ekzekutohet dhe nuk pezullohet gjatë gjykimit, me përjashtim të rasteve kur gjykata merr vendim për sigurimin e padisë.

9.4 Për VKM-në nr. 1045/2020

9.4.1 Pretendimet për shfuqizimin e VKM-së janë të pabazuara. Ndërveprimi mes dy sistemeve, NISA dhe RNSH, kryhet në mënyrë automatike përmes krijimit të kushteve teknike të nevojshme nga AKSHI, sikurse përcaktohet në pikën 13 të VKM-së. Po sipas VKM-së, sistemi NISA merr të dhëna nga regjistrat përkatës elektronikë, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për hartimin e aktit dhe veprimin noterial.

10. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar me shkrim se ka të njëjtat argumente të paraqitura nga subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë.

11. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka paraqitur prapësime me shkrim si vijon:

11.1 Për legjitimimin e kërkuases

11.1.1 Kërkesja *nuk legjitimohet*, pasi paraqitja e kërkesës në Gjykatë nga kryetari Admir Drago është bërë pa pasur asnjë tagër përfaqësimi, sipas përcaktimeve ligjore dhe statutore. Mandati i kryetarit ka përfunduar në vitin 2018 dhe është përtëritur në datën 25.3.2021. Edhe në rast se ai do të vepronte në cilësinë e kryetarit të shoqatës, gjendemi përballë një veprimi në tejkalim të tagrave të tij të dhëna nga statuti, që sjell pavlefshmërinë e kërkesës së paraqitur në Gjykatë.

11.1.2 Kërkesja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 1.3.2021, ndërsa ligji ka hyrë në fuqi në datën 28.2.2019. Gjithashtu, kërkesja nuk e ka plotësuar kërkesën brenda afatit 10-ditor, të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, prandaj ajo duhej të arkivohej.

11.1.3 Kërkesja nuk ka parashtruar asnjë argument për të provuar *legjitimimin ratione materiae*, për rrjedhojë nuk ka interes të sigurt, të drejtpërdrejtë dhe vetjak për të kundërshtuar normën. Ajo nuk ka argumentuar se si dispozitat e kundërshtuara kanë cenuar të drejtat e anëtarëve të saj në ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me përcaktimet në statut. Gjithashtu, DHKN-ja është personi juridik i krijuar me ligj, në formën e organizatës profesionale, që mund të kërkojë mbrojtjen e interesave të noterëve dhe kontrollin e normave ligjore dhe jo organizatat e tjera.

11.1.4 Për pretendimin se shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 2 dhe pikës 5 të nenit 26, si dhe nenet 41-53 të ligjit nr. 110/2018 cenojnë *parimin e hierarkisë së veprimtarisë së organeve shtetërore*, pasi bien në kundërshtim me parashikimet e KPA-së, kërkesja *nuk legjitimohet në aspektin material*.

11.1.5 Pretendimi se rregullimi sipas nenit 127 të ligjit nr. 110/2018 *cenon parimin e sigurisë juridike dhe të ligjshmërisë*, pasi bie ndesh me parashikimet e KC-së dhe KF-së, nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

11.2 Kërkesa për pezullim është e pabazuar, pasi, në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, kërkesja nuk e ka shoqëruar këtë kërkim me argumente konkrete lidhur me pasojat e rënda dhe të pariparueshme që vijnë për noterët nga zbatimi i mëtejshëm i ligjit dhe VKM-së.

11.3 Për themelin e kërkesës

11.3.1 Për ligjin nr. 110/2018

11.3.1.1 Ligji nuk cenon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit të lidhur edhe me lirinë për të zgjedhur vendin e punës. Pika 2 e nenit 8 dhe pika 4 e nenit 15 të ligjit nr. 110/2018 vendosin në pozita të barabarta të gjithë kandidatët për noterë, duke mos iu dhënë përparësi atyre kandidatëve që mund të kenë lidhje të ngushta me noterët pranë të cilëve punësohen. Është detyrë e ligjvënësit që profesionin e noterit, i cili është me karakter publik, ta normojë dhe përafrojë sa më shumë me standardet e detyrave publike, pjesë e të cilave është edhe mungesa e konfliktit të interesave përpara punësimit. Prandaj diferencimi i parashikuar në ligj është i përligjur dhe për arsye objektive, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 18 të Kushtetutës. Ligjvënësi ka vendosur që punësimin dhe licencimin t'ua nënshtrojë tërësisht kriterëve objektive dhe të meritokracisë duke shmangur trashëgiminë e profesionit dhe çdo ndikim politik, miqësor, nepotik, si dhe parandalimin e abuzimeve dhe korrupsionit me licencimin. Përcaktimet ligjore nuk e ndalojnë kandidatin për noter për t'u punësuar me qëllim fitimin e aftësive dhe të njohurive të nevojshme për të ushtruar profesionin në të ardhmen.

11.3.1.2. Caktimi i noterit në një bashki tjetër, sipas pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018, nuk nënkupton kryerjen e një pune të detyruar dhe nuk cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën për të zgjedhur vendin e punës. Parashikimi ligjor shkon në interes të vetë noterëve, pasi është një mundësi për të rritur të ardhurat e tyre dhe nxit konkurrencën. Gjithashtu, ruhet balanca mes aksesit të publikut në shërbimet noteriale dhe veprimtarisë ekonomike të noterit. Detyrimi për të punuar në një qytet tjetër është një praktikë që ndiqet edhe në rastin e profesioneve të tjera, si magistratët dhe nëpunësit civilë, me qëllim përmbushjen e interesit publik.

11.3.1.3. Kërkesja nuk ka parashtruar asnjë argument kushtetues lidhur me cenimin e parimit të sigurtë juridike nga parashikimet e shkronjës “ll” të pikës 1 të nenit 63, shkronjave “dh” dhe “gj” të nenit 81, neneve 95, 96 dhe 105 të ligjit nr. 110/2018, si dhe të VKM-së nr. 1045/2020. Ndryshe nga sa pretendon kërkesja, RNSH-ja dhe sistemi NISA janë dy baza të dhënash që nuk janë ngritur për të njëjtin qëllim. RNSH-ja është krijuar për hedhjen e të dhënave në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së mbikëqyrjes dhe kontrollit të ministrit të Drejtësisë. Ndërsa sistemi NISA ka si qëllim mirëfunksionimin dhe menaxhimin e të gjithë veprimtarisë noteriale, i cili nëpërmjet ndërveprimit me regjistrat elektronikë publikë, sistemet informatike të ministrisë, agjencitë e tjera dhe sistemin bankar i jep noterit të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e aktit noterial. Sistemi NISA dërgon të dhënat për regjistrim në RNSH në kohë reale.

11.3.1.4. Kërkesja ka pretenduar se parashikimi ligjor në fjalinë e fundit të pikës 1 të nenit 26 cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, por kjo dispozitë nuk rezulton të jetë pjesë e objektit të kërkesës. Për sa kohë është pala ajo që përcakton objektin e kërimit, Gjykata nuk mund të dalë jashtë tij. Sidoqoftë, interpretimi i kësaj dispozite nga kërkesja është i gabuar, pasi ajo lidhet me procedimin disiplinor dhe jo atë penal.

11.3.1.5. Ligji nuk kufizon të drejtën për dëmshpërblimin e noterit në rast të një vendimi jo të drejtë të Bordit Disiplinor, prandaj nuk cenohet neni 44 i Kushtetutës.

11.3.1.6. Kërkesja nuk ka sqaruar se cilat janë pasojat e pikës 2 të nenit 75 të ligjit nr. 110/2018 në sistemin e sigurimeve shoqërore, duke cenuar nenin 52 të Kushtetutës. Dispozita ligjore parashikon vetëm disa garanci minimale financiare, që duhet t'i ketë zëvendësnoteri gjatë ushtrimit të detyrës së tij dhe nuk përmban asnjë parashikim që të ndërhyjë në sistemin e sigurimeve shoqërore ose përshkallëzim të tij. Në pikën 2 të nenit 75 është parashikuar vetëm kushti i pagës mujore të zëvendësnoterit, e cila nuk mund të jetë më e ulët se 150% e pagës minimale mujore në shkallë vendi.

11.3.1.7. Pretendimi për cenimin e nenit 82 të Kushtetutës, pasi ligji nuk është shoqëruar me raport financiar, është i pabazuar. Ligji ka parashikuar se DHKN-ja miraton rregulla për nivelin e

kuotave të anëtarësimit, që bazohen në xhiron e veprimtarisë së noterit dhe mënyrën e pagesës së tyre, të cilat zbatohen vetëm pasi jep miratimin ministri i Drejtësisë. Nga ana tjetër, VKM-ja nr. 1045/2020 ka parashikuar se efektet financiare që lidhen me krijimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për zbatimin e saj mbulohen nga DHKN-ja, e cila ka burimet e saj, përveç kuotave të anëtarësimit (donacione dhe grante). Kërkuesja nuk ka argumentuar se si tarifa për sistemin NISA që mund të paguhet prej noterëve ndikon në veprimtarinë ekonomike të tyre, për rrjedhojë nuk ka argumentuar interesin që mund të cenohet nga mungesa e raportit financiar shoqërues të ligjit.

11.3.1.8. Pretendimi se cenohet *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, si pasojë e mospezullimit të ekzekutimit të vendimit të Bordit Disiplinor në rast të ankimit në gjykatë (e parashikuar nga pika 2 e nenit 52 e ligjit nr. 110/2018), nuk ka natyrë kushtetuese.

11.4. *Për VKM-në nr. 1045/2020*

11.4.1. Nuk cenohet *parimi i sigurisë juridike*, pasi VKM-ja përcakton në mënyrë të qartë mënyrën e ndërlidhjes dhe bashkëveprimin e sistemit NISA me bazat e tjera të të dhënave. Argumenti i kërkueses se ndërlidhjet që parashikon VKM-ja me pagesë, noteri i siguron pa asnjë kosto shtesë nëpërmjet sistemit *e-Albania*, nuk qëndron.

12. Subjekti i interesuar, Dhoma Kombëtare e Noterisë, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

12.1. Kërkuesja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577/2000.

12.2. *Për themelin e kërkesës*

12.2.1. *Për ligjin nr. 110/2018*

12.2.1.1. Lidhjet familjare të kandidatit për noter, sipas pikës 2 të nenit 8 dhe të zëvendësnoterit me noterin, sipas pikës 4 të nenit 15 të ligjit nr. 110/2018, janë koncepte të sanksionuara në shumë vende, ku noterët cilësohen si funksionarë publikë, që ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe nuk mund të punojnë nën mbikëqyrjen e anëtarëve të familjes së tyre.

12.2.1.2. Pretendimi për *cenimin e lirisë ekonomike*, si pasojë e transferimit në një bashki tjetër, sipas parashikimit të pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018, është i pabazuar. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar se ndonëse profesioni i noterit është profesion i lirë, i nënshtrohet rregullave si të gjitha profesionet e tjera. Veprimtaria e noterit ka disa karakteristika thelbësore, që e bëjnë atë një veprimtari publike nga karakteri dhe rëndësia.

12.2.1.3. Për procedurat disiplinore është parashikuar ndarja midis strukturave përgjegjëse, nën varësinë e ministrit të Drejtësisë për hetimin disiplinor dhe të Bordit Disiplinor për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore. Kjo ndarje siguron që procedimi disiplinor të jetë në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

12.2.1.4. Paga e zëvendësnoterit është vendosur për të siguruar një dysheme për ushtrimin cilësor të veprimtarisë dhe jo për të ndikuar në sistemin e sigurimeve shoqërore.

12.2.1.5. Sistemi NISA është sistem i ngjashëm me ato që përdoren në shumë vende të tjera evropiane. Ai organizohet nga DHKN-ja, si personi juridik publik që kujdeset për mbarëvajtjen e noterisë. Vlefshmëria e aktit noterial, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 105 të ligjit nr. 110/2018, programuar edhe në sistemin NISA, jep garanci dhe siguri për shërbimin noterial si një shërbim publik që i ofrohet qytetarit. Një nga funksionet e këtij sistemi është komunikimi dhe ndërveprimi me baza të dhënash të tjera shtetërore.

12.3. *Për VKM-në nr. 1045/2020*

12.3.1. VKM-ja e vendos Ministrinë e Drejtësisë në rolin e monitoruesit/inspektuesit të shërbimit noterial. Nëpërmjet sistemit sigurohet që çdo akt noterial do të numërohet me një numër unik identifikues; arkivat dokumentare dhe elektronike të çdo zyre noteriale do të jenë të njëjta; nuk do të qarkullojë asnjë dokument noterial përveç dokumenteve të arkivuara në sistemin NISA; gjenerimi i faturës nga sistemi do të sigurojë aplikimin vetëm për tarifat e shërbimeve të

miratuara; krijohet mundësi raportimi për strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe akses në çdo kohë dhe për çdo kërkesë specifike nga këto struktura.

III Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarës

13. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 14, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për legjitimitimin e organizatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyrë ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të provohet që subjektet me legjitimitet të kushtëzuar përfaqësojnë të gjithë profesionistët e asaj fushe, pasi, në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimitimin e tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 6.3.2014; nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

A.1 Për legjitimitimin *ratione personae*

16. Kërkesja ka parashtruar se legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës, pasi është person juridik i regjistruar rregullisht dhe se ligji nr. 110/2018 dhe VKM-ja nr. 1045/2020 sjellin efekte të drejtpërdrejta për noterët, pasi ndikojnë në mënyrën e ushtrimit të profesionit të tyre.

17. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka pretenduar se kërkesja *nuk legjitimohet*, pasi paraqitja e kërkesës në Gjykatë nga kryetari Admir Drago është bërë pa pasur asnjë tagër përfaqësimi, ndryshe nga sa përcakton ligji dhe statuti. Mandati i kryetarit ka përfunduar në vitin 2018 dhe është përtëritur në datën 25.3.2021. Edhe në rast se ai do të vepronte në cilësinë e kryetarit të shoqatës, gjendemi përballë një veprimi në tejkalim të tagrave të dhëna nga statuti, që sjell pavlefshmërinë e kërkesës së paraqitur.

18. Gjithashtu, ky subjekt ka prapësuar se kërkesja nuk ka argumentuar se si dispozitat ligjore dhe nënligjore kanë cenuar të drejtat e anëtarëve të unionit në ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me përcaktimet në statut. DHKN-ja është personi juridik i krijuar me ligj, në formën e organizatës profesionale, që legjitimohet për mbrojtjen e interesave të noterëve, duke kërkuar, nëse është rasti, kontrollin e normave ligjore dhe jo organizatat e tjera.

19. Në lidhje me aspektin formal të legjitimitimit të kërkuarës në këtë gjykim kushtetues, Gjykata vëren se shoqata “Unioni i Noterëve Shqiptarë” është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 3861, datë 14.5.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë fillimisht në datën 27.2.2021, e nënshkruar nga disa anëtarë të shoqatës, ndër të cilët edhe Admir Drago. Pas plotësimit të dokumentacionit, kërkesa është riparaqitur e nënshkruar vetëm nga ky i fundit, në cilësinë e kryetarit të shoqatës.

20. Kompetencat e kryetarit të shoqatës janë të parashikuara në nenin 15 të statutit. Ndërsa në nenin 14 të tij parashikohet se kryetari i Bordit Drejtues është edhe kryetari i shoqatës, i cili

përfaqëson shoqatën në marrëdhënie me të tretët dhe përpara të gjitha organizmave shtetërorë. Bordi i shoqatës, bazuar në nenin 12 të statutit, ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 3-vjeçare. Anëtarët e bordit dhe kryetari i tij kanë të drejtë të rizgjidhen (pika 11.3 e nenit 12). Nisur nga ky parashikim statutor, subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka pretenduar se si anëtarët e Bordit edhe kryetari i shoqatës kanë një mandat 3-vjeçar, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë kishte përfunduar.

21. Në rastin konkret rezulton se me vendimet nr. 1 dhe nr. 2, datë 5.1.2015 të Asamblesë së Përgjithshme, ndër të tjera, Admir Drago është zgjedhur kryetar i shoqatës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3861/1, datë 23.7.2015, ka vendosur pranimin e kërkesës së shoqatës për regjistrimin e këtyre vendimeve. Në datën 29.1.2021 Asambleja e Përgjithshme e shoqatës ka rizgjedhur të njëjtin kryetar, me mandat 3-vjeçar. Kërkesja në datën 2.3.2021 e ka paraqitur vendimin e asamblesë për regjistrim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 3861/2, datë 25.3.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe depozitimin e praktikës dokumentare në aneksin e regjistrit të organizatave jofitimprurëse.

22. Për sa më lart, Gjykata konstaton se Admir Drago ka ushtruar funksionin e kryetarit të shoqatës pa ndërprerje që prej vitit 2015. Deri në vitin 2021 nuk rezulton i regjistruar asnjë vendim për zgjedhjen e ndonjë kryetari tjetër ose për përfundimin e mandatit të tij, dhe ai është rizgjedhur në këtë detyrë në vitin 2021. Gjithashtu, Gjykata vëren se në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë (në datën 27.2.2021) Asambleja e Përgjithshme e kishte shprehur vullnetin (në datën 29.1.2021) për rizgjedhjen e kryetarit të shoqatës. Pavarësisht se ky vendim i Asamblesë është regjistruar në datën 25.3.2021 (pas depozitimit të kërkesës në Gjykatë), vendimi i Asamblesë së Përgjithshme konfirmon veprimin e kryetarit sipas tagrave të tij. Si rrjedhim, Gjykata çmon se kërkesa plotëson edhe kriterin formal të legjitimitetit të organizatës në gjykimin kushtetues.

23. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se është i pabazuar pretendimi i subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, se DHKN-ja është e vetmja organizatë që legjitimohet për mbrojtjen e interesave të noterëve, duke kërkuar edhe kontrollin e normave ligjore. Gjykata vëren se organizatat, si subjekte të parashikuara nga shkronja “h”, pika 1, e nenit 134 të Kushtetutës, përfshijnë persona juridikë të organizuar në forma të ndryshme, ndër të cilat edhe shoqatat, që krijohen me ligj ose me vullnetin e lirë të anëtarëve dhe që organizohen për mbrojtjen e një qëllimi të caktuar, i cili mund të jetë në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të tyre. Prandaj, krijimi i personave juridikë me ligj, me qëllim mbrojtjen e interesave të subjekteve të caktuara, sikurse është në këtë rast DHKN-ja, nuk përjashton të drejtën e personave të tjerë juridikë, të krijuar vullnetarisht, pra organizata të tjera, me objekt veprimtari të ngjashme, për të paraqitur kërkesë për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjeve ose akteve normative që rregullojnë fusha të caktuara, kur ato justifikojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë, pasi Kushtetuta nuk bën dallim ndërmjet tyre në këtë drejtim.

24. Sikurse u theksua më sipër (*shih paragrafin nr. 19 të vendimit*), kërkesja është regjistruar si person juridik dhe sipas përmbajtjes së aktit të themelimit ajo është organizatë jofitimprurëse për mbrojtjen e të drejtave të noterëve, në respektim të ligjit, të konkurrencës mes tyre, për ruajtjen e etikës profesionale dhe personale ndërmjet njëri-tjetrit (neni 2, pika 1).

25. Gjithashtu, ajo ka parashtruar para Gjykatës argumente në lidhje me cenimin që dispozitat e akteve objekt i këtij kontrolli kushtetues u bëjnë të drejtave të noterëve, të cilat kjo organizatë ka për mision t'i mbrojtë. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesja ka arritur të provojë interesin e saj dhe se ajo legjitimohet *ratione personae* për ta vënë atë në lëvizje¹.

A.2 Për legjitimitetin ratione temporis

26. Në lidhje me legjitimitetin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Gjykata konstaton se ligji nr. 110/2018 ka hyrë në fuqi në datën 28.2.2019, ndërsa VKM-ja nr. 1045/2020 ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

¹ Gjyqtari A. Binaj votoi kundër legjitimitetit të kërkesës.

në datën 4.2.2021. Ndërkohë kërkesa është depozituar në Gjykatë nëpërmjet shërbimit postar në datën 27.2.2021 (ditë e shtunë) dhe është regjistruar në Gjykatë në datën 1.3.2021 (ditë e hënë). Me shkresën e datës 2.3.2021 është kërkuar plotësimi i kërkesës brenda 10 ditëve nga marrja dijani e shkresës.

27. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, gjatë seancës plenare ka parashtruar se kërkesja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 1.3.2021, kurse ligji ka hyrë në fuqi në datën 28.2.2019. Sipas tij, në datën 2.3.2021 është kërkuar plotësimi i kërkesës, çka është bërë në datën 16.3.2021, në tejkallim të afatit 10-ditor, për rrjedhojë ajo duhej të arkivohej. Gjithashtu, edhe subjekti i interesuar, DHKN-ja, ka prapësuar gjatë seancës plenare se kërkesa është paraqitur jashtë afatit 2-vjeçar, të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577/2000.

28. Gjykata vëren se bazuar në pikën 3 të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa mund të paraqitet dorazi ose me postë dhe në rastin e dërgimit të kërkesës me postë, datë e paraqitjes së saj konsiderohet data e dorëzimit në zyrën postare. Gjithashtu, në interpretim të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 8577/2000, kur kërkesa paraqitet e plotësuar brenda afatit, si datë e paraqitjes së saj konsiderohet data e paraqitjes për herë të parë në Gjykatë.

29. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa është paraqitur në datën 27.2.2021, pra brenda afatit ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i subjekteve të interesuara se kërkesa është paraqitur jashtë afatit, është i pabazuar.

A.3 Për legjitimitimin ratione materiae

30. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkesja ka parashtruar në mënyrë të përmblëdhur se dispozitat objekt kërkesë cenojnë nenet 18, 26, 44, 52 dhe 82 të Kushtetutës, dhe parimet e prezumimit të pafajësisë, të sigurisë juridike, të hierarkisë së normave juridike, të hierarkisë së veprimtarisë së organeve shtetërore, si dhe të drejtën për ushtrimin e profesionit dhe atë për një proces të rregullt ligjor.

31. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se kërkesja nuk legjitimohet në aspektin material për pretendimin se shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 2 dhe pika 5 të nenit 26, si dhe nenet 41-53 të ligjit nr. 110/2018 janë në kundërshtim me parashikimet e KPA-së dhe ligjit nr. 8678/2001, pasi nuk ka argumentuar se si këto dispozita kanë cenuar të drejtat e anëtarëve të saj.

32. Gjykata vlerëson se dispozitat në fjalë kanë të bëjnë me masat disiplinore, krijimin dhe funksionimin e Bordit Disiplinor dhe kryerjen e procedurës disiplinore. Ato ndikojnë në të drejtat e noterëve, mbrojtja e të cilave përbën dhe qëllimin e veprimtarisë së kërkuar, prandaj argumenti i paraqitur nga subjekti i interesuar është i pabazuar. Si përfundim, Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet edhe *ratione materiae* në këtë gjykim kushtetues dhe në vijim do të analizojë pretendimet e ngritura prej saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të neneve 18 dhe 49 të Kushtetutës

33. Kërkesja ka pretenduar se pika 2 e nenit 8 dhe pika 4 e nenit 15 të ligjit nr. 110/2018, në të cilat parashikohet respektivisht se kandidati për noter nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt i shkallës së dytë me noterin pranë të cilit punon dhe se zëvendësnoteri nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt i shkallës së dytë i noterit pranë të cilit emërohet, cenojnë parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si dhe të drejtën për të përfutur mjetet e jetesës me punë të ligjshme dhe të drejtën për të ushtruar lirisht profesionin.

34. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, kanë prapësuar se nuk cenohen nenet 18 dhe 49 të Kushtetutës, pasi ligji synon një proces cilësor të pranimin në formimin fillestar, bazuar në parimin e meritokracisë, barazisë para ligjit duke shmangur çdo ndikimi politik, miqësor, nepotik dhe duke parandaluar abuzimet dhe korrupsionin në procesin e licencimit, prandaj diferencimi i parashikuar në ligj është i përligjur dhe për arsye objektive, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 18 të Kushtetutës. Përcaktimet ligjore nuk e ndalojnë kandidatin për noter të punësohet me qëllim fitimin e aftësive dhe njohurive të nevojshme për të

ushtruar profesionin në të ardhmen. Neni 49 i Kushtetutës nuk cenohet, sepse drejta për t'u punësuar nuk është absolute, por iu nënshtrohet rregullimeve të veçanta, të përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës.

35. Subjekti i interesuar, DHKN-ja, ka parashtruar se parashikimet në pikën 2 të nenit 8 dhe pikën 4 të nenit 15 të ligjit janë koncepte të sanksionuara në shumë vende, ku noterët cilësohen si funksionarë publikë që e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe nuk mund të punojnë nën mbikëqyrjen e anëtarëve të familjes së tyre.

36. Gjykata vëren se edhe pse kërkesja e mbështet pretendimin e saj në nenet 18 dhe 49 të Kushtetutës, në thelb, argumentet e ka në drejtim të cenimit të parimit të barazisë në ligj dhe mosdiskriminimit. Prandaj, në vijim, Gjykata do ta analizojë atë në këtë këndvështrim.

37. Pika 2 e nenit 8 të ligjit nr. 110/2018 parashikon: *"Kandidati për noter nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt deri në shkallë të dytë me noterin pranë të cilit punon"*, ndërsa pika 4 e nenit 15 të po këtij ligji parashikon: *"Zëvendësnoteri nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt deri në shkallë të dytë i noterit pranë të cilit emërohet."*

38. Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. Krahës kësaj dispozite kushtetuese qëndron edhe neni 14 i KEDNJ-së, i cili u ndalon shprehimisht shteteve anëtare kufizimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga kjo Konventë për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, besimi ose pikëpamjet politike, si dhe prejardhjes sociale dhe kombëtare.

39. Gjykata në jurisprudencën e saj ka trajtuar gjerësisht parimin e barazisë në ligj, duke theksuar se ai synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta, dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 31, datë 4.10.2021; nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues bazuar në kushtet dhe kriteret e nenit 18 të Kushtetutës, jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar disa standarde. Në të tilla raste Gjykata shqyrton nëse ligji parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se e konstaton këtë fakt, ajo vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përlligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përlligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përlligjur, por duhet edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënës të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, ato duhet të jenë efektive, pra të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton diferencimin e përlligjur dhe arsyen objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Nisur nga sa më lart, Gjykata vëren se parashikimet ligjore të kundërshtuara vendosin një diferencim nisur nga lidhjet familjare të kandidatëve për noter dhe zëvendësnoter, pra për ato kategori kandidatësh për noter dhe zëvendësnoter që janë bashkëshort ose të afërt deri në shkallë të dytë me noterin pranë të cilit do të punojnë ose do të emërohen. Prandaj Gjykata do të analizojë nëse në rastin në shqyrtim janë respektuar kriteret e pikës 3 të nenit 18 të Kushtetutës lidhur me përlligjen e arsyeshme dhe objektive.

42. Gjykata vëren se referuar *ratio legis*, ligjvënësi në ligjin nr. 110/2018, mes të tjerash, ka pasur si qëllim garantimin e shërbimit të noterisë dhe ushtrimit të profesionit të noterit në mënyrë

të pavarur. Gjithashtu, sipas relacionit shoqërues, ligji ka pasur si qëllim përmirësimin e nivelit të shërbimit të noterisë dhe rritjen e profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e profesionit, përmirësimin e përgatitjes së kandidatëve për profesionin e noterit dhe vendosjen e kriterëve të reja për marrjen e licencës së noterit. Në këtë drejtim, edhe në procesverbalin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut gjatë diskutimeve për ligjin në fjalë, thuhet: *“Në ligj është parashikuar sistemi i karrierës, pra një zëvendësnoter para se të bëhet i tillë, duhet t’i nënshtrohet një provimi hyrës konkurrues, do të bëjë një formim fillestar të detyrueshëm një-vjeçar, do të bëjë dy vjet praktikë pranë një noterit, dhe këtu kemi shmangur edhe konfliktin e interesit që procesi dy-vjeçar i praktikës profesionale dhe vlerësimi, të mos bëhet nga babai, vëllai apo motra, por nga një noter që nuk është në konflikt interesi dhe në fund fare, ka provimin e kualifikimit për t’u bërë zëvendësnoter, madje edhe kur merr provimin e kualifikimit, kjo nuk do të thotë që ai do të punojë nëse nuk e fiton një noter”* (shih fagen 7 të procesverbalit të datës 4.2.2018).

43. Nga përmbajtja e pikës 2 të nenit 8 dhe pikës 4 të nenit 15 të ligjit nr. 110/2018, Gjykata konstaton se i vetmi kriter përjashtues për kandidatin për noter ose për zëvendësnoterin është ai i lidhjeve të ngushta familjare me noterin pranë të cilit do të zhvillohet praktika ose do të emërohet zëvendësnoteri. Në një vështrim krahasues, dispozitat e mëparshme të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të shfuqizuara, parashikonin se për plotësimin e vendit vakant të noterit me mbushjen e moshës 65 vjeç, vdekjen ose heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit, përparësi kishte bashkëshorti ose bashkëshortja, nëse ata fitonin mbi 80% të pikëve në konkurrim ose ndërkohë ushtronin profesionin e noterit.

44. Gjykata vëren se kandidati për noter gjatë periudhës së punës pranë noterit i sigurohet një trajnim gjithëpërfshirës dhe praktik (pika 3 e nenit 8 të ligjit nr. 110/2018) dhe puna e tij vlerësohet nga noteri përgjegjës për çdo vit kalendarik. Ky vlerësim dorëzohet pranë DHKN-së, e cila përcakton rregullat për kriteret, metodologjinë dhe nivelet e vlerësimit (pika 4 e nenit 8 të ligjit nr. 110/2018). Vetëm pas përfundimit të trajnimit praktik 2-vjeçar dhe me plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr. 110/2018, kandidati për noter ka të drejtë të hyjë në provimin e kualifikimit, çka do të thotë se për periudhën e këtij trajnimi atij i duhet vlerësimi nga noteri pranë të cilit do të punojë. Nga ana tjetër, kalimi me sukses i provimit të kualifikimit mundëson ushtrimin e funksionit të zëvendësnoterit (shkronja “ç” e nenit 3 të ligjit nr. 110/2018). Ky i fundit përpara se të marrë licencën e noterit duhet të emërohet pranë një noterit. Vetëm pasi të fitojë një vjetërsi prej të paktën 3 vjetësh në profesionin e zëvendësnoterit, bazuar në kontratën që lidh me noterin pranë të cilit emërohet, zëvendësnoteri mund të shfaqë interes për vendet vakante për noter në çdo bashki (pika 2 e nenit 13 të ligjit nr. 110/2018). Edhe në këtë rast vazhdimësia në ushtrimin e detyrës të zëvendësnoterit është e lidhur drejtpërdrejt me noterin pranë të cilit emërohet.

45. Gjithashtu, Gjykata rithekson se në profesionin e noterit dalin në pah disa karakteristika thelbësore që e bëjnë noterinë një veprimtari publike nga karakteri dhe rëndësia e saj. Ofrimi i shërbimeve nga veprimtaria noteriale ka rëndësi të veçantë për shoqërinë dhe për institucionet shtetërore e publike ka rëndësi vlera e dokumentacionit noterial. Veprimtaria noteriale shërben për rregullimin ligjor dhe të unifikuar të aktiviteteve e të interesave të qytetarëve, duke siguruar shmangien e konflikteve e duke sjellë stabilitet në qarkullimin civil. Ofrimi për publikun i shërbimeve noteriale lidhet ngushtë me garancinë për një pasqyrim të besueshëm të fakteve ose të vullnetit të shprehur në veprimet që kryejnë qytetarët (shih vendimin nr. 3, datë 19.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

46. Nga sa më lart, Gjykata, nisur edhe nga karakteri publik i profesionit të noterit, vlerëson se ligjvënësi nëpërmjet kriterëve të përcaktuara në dispozitat në shqyrtim ka synuar të garantojë barazinë midis të gjithë kandidatëve për noter dhe zëvendësnoter, me qëllim vlerësimin objektiv të tyre në marrjen e njohurive dhe aftësive të përshtatshme për të gjitha aspektet e veprimtarisë noteriale, për të shmangur dyshimin e arsyeshëm për vlerësime subjektive, në kushtet e konfliktit të interesit ose lidhjes së kontratave fiktive me zëvendësnoterët. Vlerësimi objektiv për aftësitë profesionale të kandidatëve për noter nga ana e noterit përgjegjës, bazuar në meritokraci dhe

barazi para ligjit, shmang nepotizmin në profesionin e noterit. Gjithashtu, ushtrimi efektiv i profesionit nga ana e zëvendësnoterit garanton fitimin e aftësive të nevojshme për kryerjen më pas të detyrës së noterit. Prandaj, Gjykata vlerëson se mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit është i arsyeshëm dhe se pretendimi i kërkuësës në këtë drejtim është i pabazuar.

B.2 Për pretendimin e cenimit të neneve 26 dhe 49 të Kushtetutës

47. Kërkuësja ka pretenduar se cenohet neni 26 i Kushtetutës dhe neni 4 i KEDNJ-së, pasi parashikimi në pikën 6 të nenit 10 të ligjit, për kryerjen nga noteri të shërbimit deri në katër ditë në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor, në të cilën nuk vepron asnjë zyrë noteriale, bie ndesh me *lirinë e veprimtarisë private* dhe nënkupton kryerjen e një pune të detyruar për noterin. Sipas kërkuësës, ky parashikim bie ndesh edhe me *nenin 49 të Kushtetutës* që përcakton *të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës*, prandaj në një rast të tillë do të ishte e nevojshme të merrej edhe pëlqimi i noterit.

48. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, kanë prapësuar se pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës për të zgjedhur vendin e punës, si pasojë e transferimit në një bashki tjetër, është i pabazuar. Parashikimi ligjor shkon në interes të vetë noterëve, pasi është një mundësi për të rritur të ardhurat e tyre dhe nxitur konkurrencën mes tyre. Gjithashtu, ky parashikim synon të garantojë balancën mes aksesit të publikut në shërbimet noteriale dhe veprimtarisë ekonomike të noterit. Detyrimi për të punuar në një qytet tjetër është një praktikë që ndiqet edhe në rastin e profesioneve të tjera, si magistratët dhe nëpunësit civilë, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve me interes publik.

49. Edhe subjekti i interesuar, DHKN-ja, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e lirisë ekonomike, si pasojë e transferimit në një bashki tjetër, sipas parashikimit të pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018, është i pabazuar.

50. Gjykata vëren se edhe pse kërkuësja në parashtrimet në seancë plenare dhe në konkluzionet përfundimtare përmendi edhe cenimin e lirisë së veprimtarisë private, në thelb, pretendimin e saj e ka lidhur me cenimin e neneve 26 dhe 49 të Kushtetutës. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë përmbajtjen e pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 nën dritën e standardeve që lidhen me kryerjen e një pune të detyruar për noterin dhe me të drejtën e tij për punë.

51. Pika 6 e nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 parashikon: “Me qëllim garantimin e aksesit të duhur të publikut në shërbimet e noterisë, ministri i Drejtësisë, pas marrjes së mendimit të Dhomës, mund të urdhërojë që një noter i emëruar në një bashki të caktuar të kryejë deri në katër ditë shërbim në muaj në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor, në të cilën nuk vepron asnjë zyrë noteriale. Një noter mund të urdhërohet të kryejë jo më shumë se katër ditë shërbimi në muaj. Garantimi i infrastrukturës për ushtrimin e veprimtarisë, sipas kësaj pike, dhe mënyra e përballimit të shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.”

52. Në nenin 26 të Kushtetutës parashikohet: “Askujt nuk mund t’i kërkohej të kryejë një punë të detyruar përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.”. Ndalimi i kryerjes së punës të detyruar sanksionohet edhe në nenin 4 të KEDNJ-së dhe në shkronjën “b” të pikës 2 të Deklaratës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

53. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se me termin “punë e detyruar” nënkuptohet vetëm detyrimi i njeriut për të kryer punë në kundërshtim me vullnetin e tij, të cilën “nuk pranon ta bëjë me dashje”. Termi “punë e detyruar”, tregon çdo punë ose shërbim që i kërkohej një individi duke e kërcënuar atë me një dënim të çfarëdoshëm dhe që individi në fjalë nuk e ka pranuar me dëshirë. Për t’u quajtur “punë e detyruar” kërkohej dy kushte: mospranimi me dëshirë për ta kryer punën ose shërbimin dhe parashikimi i një sanksioni penal (*shih vendimin nr. 38, datë 15.10.1996 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Nga ana tjetër, e drejta për punë, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita

kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Garancia që i jep Kushtetuta individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit, ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Gjithsesi, e drejta për ushtrimin e një profesioni nuk është absolute, por mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t'u atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Nisur përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar, Gjykata konstaton se në raste të veçanta, për të garantuar aksesin në shërbimet noteriale, ministri i Drejtësisë, pas marrjes së mendimit të DHKN-së, mund të urdhërojë emërimin e një noteri për të ofruar shërbim deri katër ditë në muaj në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor. Rregullat për garantimin e infrastrukturës dhe mënyrën e përballimit të shpenzimeve për ushtrimin e veprimtarisë noteriale në një bashki tjetër janë përcaktuar me udhëzimin nr. 8, datë 10.6.2020 të ministrit të Drejtësisë, sipas të cilit të gjitha shpenzimet përkatëse mbulohen nga buxheti i DHKN-së.

56. Nga sa më lart, Gjykata vëren se në pamje të parë përmbajtja e pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 duket sikur krijon punë të detyruar për noterin, sepse kur ai nuk pranon të kryejë shërbimin, sjellja e tij konsiderohet si shkelje e ligjit, dhe, si e tillë, mund të shoqërohet me sanksion disiplinor (neni 26 i ligjit nr. 110/2018). Kjo, për më tepër, pasi dispozita gjen zbatim edhe ndaj noterëve që janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit që përcakton këtë rregull. Në këtë mënyrë, detyrimi që kjo dispozitë i vendos noterit për të kryer shërbim në një bashki tjetër, pra duke e kufizuar në zgjedhjen e vendit të ushtrimit të profesionit, merr tiparet e një pune të detyruar, e cila sjell ndërhyrje në nenin 49 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, propësimi i subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, se parashikimi ligjor shkon në interes të vetë noterëve, pasi është një mundësi për të rritur të ardhurat e tyre dhe nxitur konkurrencën, është i pabazuar. Si rrjedhim, pretendimi i kërkuës do të trajtohet në këndvështrim të respektimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës, i cili është edhe testi që duhet të gjejë zbatim për çdo ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore të individit.

B.2.1 Për respektimin e kriterëve të vendosura nga neni 17 i Kushtetutës

57. Në nenin 17 të Kushtetutës parashikohet se të drejtat dhe liritë kushtetuese mund të kufizohen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, nuk mund të cenojë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

58. Në rastin në shqyrtim, detyrimi për parashikimin e ndërhyrjeve me ligj, në kuptimin formal, rezulton të jetë respektuar, pasi ndërhyrja është bërë me ligj të miratuar nga Kuvendi, konkretisht ligji nr. 110/2018.

59. Për sa i përket ekzistencës së interesit publik në ndërhyrjen e ligjvënësit për vendosjen e kufizimit, koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyen publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Në çështjen konkrete, nisur nga karakteri publik i profesionit të noterit, Gjykata vëren se parashikimi ligjor i pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 ka si qëllim marrjen e masave të nevojshme në funksion të interesit publik për të rregulluar veprimtarinë noteriale në çdo bashki ku nuk ka noter. Dispozita e ka të deklaruar në tekst në mënyrë të drejtpërdrejtë interesin publik.

Ajo synon garantimin e aksesit të individit në shërbimet noteriale, në çdo bashki, duke qenë se përpara noterit kryhen veprime të rëndësishme nga ana e çdo individi. Në këtë rast ligjvënësi ka dashur të garantojë ofrimin e shërbimeve të nevojshme noteriale individëve edhe në ato bashki, në të cilat nuk vepron asnjë zyrë noteriale. Prandaj, Gjykata vlerëson se ka një interes publik, garantimi i një veprimtarie publike (ajo e noterit), i cili e justifikon ndërhyrjen.

61. Lidhur me përpjesëtimin e drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit. Në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Nisur nga përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar, Gjykata vëren se ligjvënësi, pasi ka parashikuar detyrimin e noterit që të ushtrojë funksionin e tij në një bashki tjetër, ka përcaktuar me ligj edhe disa garanci që duhet të përmbushen në këto raste, të tilla si: karakteri përjashtimor i këtij detyrimi, i cili zbatohet vetëm kur verifikohet kushti se në një bashki të caktuar nuk vepron asnjë zyrë noteriale; kohëzgjatja relativisht e shkurtër e këtij detyrimi për noterin “gjer në katër ditë shërbim në muaj”; distanca e afërt gjeografike e lëvizjes së noterit “në një bashki brenda kufijve të rrethit gjyqësor”; garantimi i infrastrukturës së nevojshme dhe i shpenzimeve, të cilat nuk rëndojnë mbi noterin që ofron këtë lloj shërbimi.

63. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se një prej garancive më thelbësore të detyrimit të noterit për të lëvizur në një bashki tjetër qëndron në procedurën e nxjerrjes së urdhrit nga ministri i Drejtësisë, pas marrjes së mendimit të DHKN-së. Lëvizja e noterit edhe pse është në kompetencë të ministrit të Drejtësisë, ajo ushtrohet prej tij në bashkërendim me DHKN-në. Kjo e fundit përfaqëson organizatën profesionale të të gjithë noterëve, të krijuar me ligj, që ka në kompetencë të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e tyre (shkronja “b” e nenit 81 të ligjit nr. 110/2018). Për këtë arsye, DHKN-ja ka përgjegjësinë të marrë masat për zbatimin në mënyrë korrekte të dispozitës, si duke u konsultuar, për sa është e mundur, me noterët përpara dhënies së mendimit për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e tyre, ashtu duke marrë në konsideratë dhe vlerësuar rrethanat e ndryshme objektive ose subjektive të tyre, si dhe duke respektuar parimin e rotacionit në caktimin e noterëve. Nga ana tjetër, ministri i Drejtësisë, në nxjerrjen e urdhrit për lëvizjen e noterit, duhet të përmbushë detyrimin ligjor për arsyetimin e aktit administrativ që lidhet me qartësinë e tij, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti, bazën ligjore të aktit, nëse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast, si dhe shpjegimin në rastin e diskrecionit. Thënë ndryshe, ndonëse ministri i Drejtësisë nuk ka detyrimin të ndjekë në çdo rast mendimin e dhënë nga DHKN-ja, gjithsesi marrja e mendimit nuk është një veprim formal, pasi ministri i Drejtësisë ka detyrimin të japë arsye të qarta në rastin kur vlerëson të vendosë ndryshe nga mendimi i dhënë prej dhomës.

64. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se kufizimi i vendosur nga parashikimi i pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 përmbush kriterin e proporcionalitetit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës për antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite është i pabazuar.

B.3 Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

B.3.1 Për pikat 2 dhe 5 të nenit 26, nenet 41-53, shkronjën “ll” të pikës 1 të nenit 63, shkronjat “dh”, “gj” të nenit 81, nenet 95, 96, 105, 106 dhe 127 të ligjit nr. 110/2018

65. Kërkuësja ka pretenduar se dispozitat e parashikuara në pikat 2 dhe 5 të nenit 26, nenet 41-53, shkronjën “ll” të pikës 1 të nenit 63, shkronjat “dh”, “gj” të nenit 81, si dhe nenet 95, 96, 105,

106 cenojnë parimin e sigurisë juridike, pasi noterët duhet të paguajnë tarifa dhe kosto të papërcaktuara në ligj dhe të paqarta për masën dhe mënyrën e përcaktimit të tyre. Sipas kërkuësesh tashmë janë të krijuara dhe funksionojnë të gjitha sistemet elektronike shtetërore pa pagesë, ku noterit ka akses të plotë në kohë reale për të kryer veprimtarinë e tij dhe nuk është e nevojshme të shtohet edhe një sistem i ri elektronik me pagesë. Gjithashtu, sipas saj, dispozitat e sipërcituara të ligjit nr. 110/2018 bien ndesh me parashikimet e KC-së, KF-së, KPA-së, ligjin nr. 10325/2010, ligjin nr. 9880/2008, ligjin nr. 8678/2001, si dhe ligjin nr. 90/2012. Ndërsa neni 127 i ligjit, i cili parashikon procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nën regjimin pasuror martesor, bie ndesh me nenin 358 të KC-së dhe nenet 76, 90 dhe 103 të KF-së, pasi ka ndërhyrë duke rregulluar dy marrëdhënie të rregulluara nga këto kode. Gjithsesi, gjatë seancës plenare kërkuësja saktësoi se pretendimi i saj për këto dispozita në thelb ka të bëjë me cenimin e parimit të sigurisë juridike.

66. Sipas kërkuësesh cenohet edhe e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale, e parashikuar nga neni 35 i Kushtetutës, pasi krijimi dhe funksionimi i sistemit NISA nuk është bërë në përputhje me ligjin nr. 10325/2010. DHKN-ja, si institucioni administrues i të dhënave nuk legjitimohet në këtë funksion, pasi të dhënat shtetërore duhet të administrohen nga një person publik ose privat që ushtron funksione publike (shkronja “b”, pika 1, e nenit 2 të ligjit nr. 10325/2010) dhe DHKN-ja nuk ushtron funksion publik.

67. Kërkuësja ka pretenduar se edhe pse neni 3 i ligjit nr. 110/2018 parashikon se noterit është person fizik që licencohet nga ministri i Drejtësisë, kompetencën për ta pezulluar nga detyra dhe për t’i hequr licencën, sipas pikave 2 dhe 5 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018, e ka Bordi Disiplinor. Sipas saj, konstatohet një mungesë e koherencës së ligjit, midis këtyre parashikimeve dhe shkronjës “e” të nenit 21 të ligjit, ku përcaktohet se, kur noterit ka marrë masë disiplinore heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit, në përputhje me nenin 26 të ligjit, kjo masë jepet me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Në këtë rast ministri i Drejtësisë ka kompetencë thjesht formale, pasi detyrohet në nxjerrjen e urdhrat për heqjen e licencës pas vendimmarrjes së Bordit.

68. Nga ana tjetër, kërkuësja ka parashtruar se shkronja “a” e nenit 28 të ligjit nr. 110/2018, duke parashikuar që në përfundim të hetimit disiplinor ministri i Drejtësisë i paraqet Bordit Disiplinor raportin e hetimit, i atribuon këtij të fundit kompetencën e vendimmarrjes për fillimin ose jo të procedimit disiplinor. Duke qenë se ligji nr. 8678/2001 procedimin disiplinor ia ka atribuuar si kompetencë vetëm ministrit të Drejtësisë, nuk mundet që ajo t’i jepet një organi *ad hoc* të DHKN-së, sikurse është Bordi. Gjithashtu, për shkak të mungesës së harmonisë mes dispozitave të ligjit, Bordi ka në përbërje të tij 2 anëtarë të zgjedhur nga ministri i Drejtësisë dhe, nga ana tjetër, në përfundim të procedimit disiplinor merr vendimet më të rëndësishme që ndikojnë në veprimtarinë profesionale të noterit.

69. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, kanë prapësuar se kërkuësja nuk ka parashtruar asnjë argument lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike. Sipas tyre, disa nga argumentet e kërkuësesh për paqartësinë ose pakuptueshmërinë e dispozitave të ligjit nr. 110/2018, në thelb, lidhen me përplasjen mes normave ligjore në fuqi dhe, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

70. Subjekti i interesuar, DHKN-ja, ka argumentuar se për procedurat disiplinore është parashikuar ndarja midis strukturave përgjegjëse: ministrit të Drejtësisë në hetimin disiplinor dhe Bordit Disiplinor në shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore. Kjo ndarje siguron që procedimi disiplinor të jetë në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

71. Gjykata vëren se në thelb pretendimet e ngritura nga kërkuësja kanë të bëjnë me cenimin e parimit të sigurisë juridike, si për shkak të paqartësisë në përmbajtje të dispozitave të ligjit nr. 110/2018, ashtu edhe me përplasjen ndërmjet dispozitave të ligjeve të ndryshme ose me harmonizimin e tyre.

72. Dispozitat e kundërshtuara janë shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 2 të nenit 26, që parashikojnë shkeljet disiplinore dhe masat kundër noterit; pika 5 e nenit 26 që rregullon masat

disiplinore që jepen nga ministri i Drejtësisë dhe ato që jepen vetëm me vendim të Bordit Disiplinor; nenet 41-53 që rregullojnë të gjitha hapat e procedimit disiplinor ndaj noterit dhe zëvendësnoterit; shkronja “l” e nenit 63, që përcakton detyrat e noterit, i cili, mes të tjerave regjistron aktet dhe veprimet noteriale në format elektronik nëpërmjet sistemit të krijuar nga DHKN-ja; shkronjat “dh” dhe “gj” të nenit 81, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e DHKN-së, dhe konkretisht me krijimin e sistemit NISA; neni 95 që përcakton dokumentet elektronike; neni 96 që përcakton qasjen dhe aplikimin nëpërmjet sistemit elektronik në regjistrat elektronikë publikë; shkronja “a” e pikës 1 të nenit 105 që lidhet me përmbajtjen e aktit noterial ku citohet se akti noterial, ndër të tjera, përmban edhe *“identifikuesin elektronik të aktit”*; fjalia *“Çdo akt dhe veprim noterial merr nga sistemi elektronik një numër unik elektronik”* në nenin 106, që rregullon regjistrimin e akteve dhe veprimeve noteriale, si dhe neni 127 që përmban procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nën regjimin pasuror martesor.

73. Gjykata rithekson se parimi i sigurisë juridike garanton parashikueshmërinë e sistemit normativ. Siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

74. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se dispozitat e kundërshtuara nuk janë të paqarta dhe të papërcaktuara dhe as nuk e bëjnë ligjin të paqartë në tërësinë e tij, si një kërkesë e parimit të sigurisë juridike. Konkretisht, ligji nr. 110/2018 ka parashikuar Bordin Disiplinor si organ kolegjal, në të cilin 2 anëtarë zgjidhen nga ministri i Drejtësisë, 2 anëtarë nga Asambleja e Përgjithshme e DHKN-së, nga radhët e noterëve, dhe 1 anëtar nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës. Për t'i dhënë garanci më të mëdha procedimit disiplinor të noterit, si dhe për të shmangur faktin që ai të jetë vetëm kompetencë e ministrit të Drejtësisë, ligji ka përcaktuar kompetencën e Bordit Disiplinor për marrjen e masave disiplinore më të rënda (pezullim nga detyra dhe heqjen e licencës, sipas pikës 5 të nenit 26). Në këto raste urdhri i ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës (sipas shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 21) merret pas vendimmarrjes së Bordit.

75. Nga ana tjetër, në vlerësimin e Gjykatës krijimi i sistemit të ri NISA i përgjigjet situatës aktuale shoqërore për digjitalizim, që karakterizohet me zhvillime dinamike të teknologjisë dhe përdorimin gjithmonë e më shumë të saj. Ky sistem është lënë në kompetencë të DHKN-së, si organizatë profesionale e krijuar me ligj, e cila mbron të drejtat e noterëve. Në këtë drejtim, DHKN-ja krijon, administron, përmirëson dhe përditëson në vazhdimësi sistemin NISA, me qëllim prodhimin dhe regjistrimin e dokumenteve noteriale, si dhe menaxhimin e veprimtarisë noteriale kombëtare (shkronja “dh” e nenit 81 të ligjit nr. 110/2018).

76. Gjithashtu, duke qenë se dhoma ka në kompetencë, ndër të tjera, mbledhjen dhe administrimin e kuotave të anëtarësimit dhe të tarifave të tjera të caktuara (shkronja “e” e nenit 81 të ligjit nr. 110/2018) dhe administrimin e fondeve dhe aseteve të saj (shkronja “ë” e nenit 81), ligjvënësi ka lënë në kompetencë të DHKN-së përcaktimin edhe të tarifave që duhet të paguhen nga noterët për përdorimin e sistemit NISA, tarifa të cilat aktualisht janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme. Sikurse rezultoi edhe gjatë seancës plenare, përfaqësuesja e subjektit të interesuar, Kuvendit, u shpreh se ligjvënësi nuk mund të parashikonte një tarifë të tillë, pasi sistemi do të përdorej nga DHKN-ja dhe është në funksion të saj dhe të veprimtarisë së noterëve, prandaj janë strukturat e DHKN-së që do të vendosin në lidhje me mbarëvajtjen e tij.

77. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se dispozitat e kundërshtuara nuk janë të paqarta në përmbajtje dhe nuk lënë vend për arbitraritet në zbatimin e tyre, prandaj pretendimi i kërkuës në këtë drejtim është i pabazuar.

78. Për sa i përket kërimit për papajtueshmërinë midis dispozitave të ligjeve të ndryshme, Gjykata thekson se, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të Kushtetutës, në juridiksionin e saj hyjnë pajtueshmëria e ligjeve dhe e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën. Gjykata ka evidentuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme ose ligjeve dhe kodeve. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër, *lex superior derogat inferiori* (shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Ndërsa në rastin e normave me të njëjtën fuqi juridike, Gjykata thekson se zbatohen parimet, sipas të cilave norma e posaçme ka epërsi ndaj normës së përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme. Në këtë kuptim, mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata (shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 9, datë 1.3.2021; nr. 5, datë 5.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

79. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuës që lidhen me përplasjen ndërmjet ligjeve ose harmonizimin e dispozitave të ligjeve të ndryshme ndërmjet tyre nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B.3.2 Për fjalinë e fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018

80. Kërkuësja ka pretenduar se fjalja e fundit e pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018 cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi veprimet ose mosveprimet e noterit që përbëjnë vepër penale, janë vetëm kompetencë e gjykatës dhe jo e Bordit Disiplinor.

81. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se dispozita nuk është pjesë e objektit të kërkesës. Për sa kohë është pala ajo që e përcakton objektin e gjykimit, nuk mund të dilet jashtë këtij objekti. Sidoqoftë, sipas këtij subjekti, interpretimi i kryer nga kërkuësja është i gabuar, pasi parashikimi ligjor ka efekt në kuadër të procedimit disiplinor administrativ dhe jo të procedimit penal. Dispozita përmban edhe garanci ligjore për subjektin, duke vendosur afatin e parashkrimit të shkeljes (5 vjet), pas përfundimit të të cilit konsiderohet se shkelja nuk ka ndodhur.

82. Gjykata fillimisht konstaton se kërkitimi për shfuqizimin e fjalisë së fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018 nuk është shënuar në pjesën hyrëse të kërkesës, si pjesë e objektit të saj. Megjithatë, si në përmbajtje të kërkesës së paraqitur në Gjykatë, ashtu edhe gjatë seancës plenare publike, kërkuësja e ka parashtruar këtë pretendim duke identifikuar saktësisht normën që kërkon të shfuqizohet. Prandaj, argumenti i subjektit të interesuar se dispozita nuk është pjesë e objektit të kërkesës, është i pabazuar.

83. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se kërkuësja edhe pse ka pretenduar shfuqizimin e fjalisë së fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018 për shkak të cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, në thelb, pretendimet e saj edhe për këtë dispozitë kanë të bëjnë me cenimin e parimit të sigurisë juridike. Për rrjedhojë, në kuptim të parimit *iura novit curia* Gjykata edhe këtë pretendim do ta trajtojë në këndvështrim të respektimit të këtij parimi.

84. Dispozita e kundërshtuar është fjalja e fundit e pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018. Pika 1 e këtij neni parashikon fillimisht tri raste të shkeljeve disiplinore, kur noteri: a) vepron në kundërshtim me ligjin; b) kryen veprime ose mosveprime që janë në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale; c) shkel detyrimet ligjore të anëtarit të Dhomës të parashikuara në këtë ligj. Ndërsa fjalja e fundit e pikës 1 përcakton se “*shkelje disiplinore janë edhe veprimet ose mosveprimet që përbëjnë vepër penale, pavarësisht faktit nëse vepra penale është shlyer, ndjekja penale nuk është filluar ose nuk mund të vazhdojë, noterit është rehabilituar ose ka përfutur nga fajja apo amnistia, me kushtin që nuk kanë*

kaluar më shumë se 5 vjet nga momenti i shkeljes.”. Duke qenë se në praktikën e Gjykatës është theksuar se, si rregull, përgjegjësia penale konkurron me përgjegjësinë administrative ose disiplinore (*shih vendimin nr. 37, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*), edhe ligjvënësi nëpërmjet këtij parashikimi ligjor për disa veprime dhe mosveprime që përbëjnë vepër penale ka përcaktuar se krahas procedimit penal ato përbëjnë shkak edhe për procedim administrativ.

85. Në vijim të sa më lart, vihet re se fjalë e fundit e pikës 1 të nenit 26 të ligjit objekt shqyrtimi krijon disa paqartësi në kuptimin e saj. Si rregull, duke qenë se çdo vepër penale është shkelje ligjore, lidhëza “edhe” në përmbajtje të kësaj fjalie jep kuptimin që shkeljet disiplinore të përcaktuara në të janë në shtesë të atyre të listuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të të njëjtit nen dhe, për rrjedhojë, ato përfshihen në përmbajtjen e shkronjës “a” (shkeljet disiplinore në rastet kur noteri vepron në kundërshtim me ligjin). Gjithashtu, teknika legjislative e përdorur brenda së njëjtës dispozitë është e ndryshme, sepse në tekstin e fjalisë së fundit të pikës 1 të nenit 26 shkeljet disiplinore përfshijnë veprimet dhe mosveprimet e noterit, ndërsa në pjesën tjetër të pikës 1 ligjvënësi u referohet shkeljeve disiplinore duke përdorur vetëm konceptin e veprimit. Nga ana tjetër, për shkak të mënyrës së formulimit, qëllimi që ndjek fjalë e fundit e pikës 1 të nenit 26 është i paqartë, pasi për llojin e shkeljeve disiplinore mbivendoset me pjesën tjetër të po kësaj pike, ndërsa për afatin e parashkrimit mbivendoset me pikën 5 të nenit 26. Në këtë mënyrë, përmbajtja e fjalisë së fundit të pikës 1 të nenit 26, krijon paqartësi nëse shkeljet disiplinore të noterëve krijojnë një rregull të ndryshëm lidhur me konkurrimin e përgjegjësi (penale dhe disiplinore).

86. Ndërkohë në lidhje me përgjegjësinë disiplinore për shkak të veprës penale, Gjykata konstaton se në ndryshim nga legjislacioni penal, fjalë e fundit e pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018 ka krijuar një institut të ri, atë të *shlyerjes së veprës penale*, i cili nuk njihet nga Kodi Penal (KP) ose ligjet e posaçme në këtë drejtim. Këto të fundit njohin institutin e parashkrimit të ndjekjes penale (neni 66 i KP-së), të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit (neni 68 i KP-së), të rehabilitimit (neni 69 i KP-së), të faljes (neni 70 i KP-së), të amnistisë (neni 71 i KP-së), të shuarjes së veprës penale ose të dënimit (neni 480 Kodi i Procedurës Penale), si dhe të përfundimit të vuajtjes së dënimit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Po në këtë këndvështrim, dispozita e kundërshtuar, duke parashikuar se përbën shkelje disiplinore edhe rasti kur ndjekja penale *nuk është filluar ose nuk mund të vazhdojë*, është e paqartë se si në këto raste organi disiplinor merr kompetencën për të deklaruar se veprimet ose mosveprimet e noterit përbëjnë vepër penale.

87. Për llojet e veprave penale, të cilat mund të konsiderohen edhe shkelje disiplinore, subjekti i interesuar, Kuvendi, gjatë pyetjeve të drejtuara në seancën plenare, ka parashtruar se në këndvështrimin e tij veprat penale lidhen vetëm me ushtrimin e detyrës së noterit. Ndërsa Gjykata vëren se dispozita objekt shqyrtimi nuk e ka të përcaktuar nëse shkelje disiplinore do të konsiderohen veprimet ose mosveprimet, të cilat përbëjnë vepër penale, që janë pjesë e veprimtarisë noteriale. Në një interpretim të zgjeruar të dispozitës objekt shqyrtimi, ajo parashikon përgjegjësinë disiplinore të noterit për shkak të kryerjes së çdo veprë penale, pavarësisht nëse është krim ose kundërvajtje penale, pavarësisht formës së fajësisë (me dashje ose nga pakujdesia), llojit ose masës së dënimit të caktuar, nëse vepra penale e kryer ka ose jo lidhje me detyrën e noterit, qoftë kur nuk parashikohet më nga ligji si vepër penale, përfshirë rastet e shfuqizimit të saj për çfarëdolloj shkak. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës dispozita në fjalë, duke mos përcaktuar rastet që përbëjnë shkelje disiplinore, paraqet edhe rrezikun e arbitraritetit gjatë zbatimit të saj në praktikë. Për më tepër, nga shpjegimi i subjekteve të interesuara nuk u evidentua ndonjë arsye bindëse për këtë qasje të ligjvënësit.

88. Si përfundim, Gjykata çmon se parashikimi ligjor në fjalinë e fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018 nuk ndryshon rregullin se përgjegjësia disiplinore e noterit konkurron me atë penale, por për shkak të paqartësisë të formulimit të saj, bie në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, prandaj ky pretendim i kërkuar është i bazuar, ndaj ajo duhet të shfuqizohet si e papajtueshme me Kushtetutën.

B.4 Për pretendimin e cenimit të nenit 44 të Kushtetutës

89. Kërkesja ka pretenduar se cenohet neni 44 i Kushtetutës, lidhur me të drejtën për t'u zhdëmtuar, pasi ligji nuk përcakton se cili do të jetë organi dëmshpërblyes në rastin e një vendimi të padrejtë të marrë nga Bordi Disiplinor. Në këtë rast përgjegjësia për dëmin e shkaktuar u kalon noterëve të tjerë, duke qenë se Bordi mbështetet administrativisht nga DHKN-ja.

90. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, kanë prapësuar se pretendimi se zhdëmtimi nga Bordi passjell detyrimin e noterëve të tjerë për dëmshpërblyer, nuk është argument kushtetues, pasi nuk evidentohet asnjë cenim i së drejtës për t'u dëmshpërblyer.

91. Gjykata thekson se neni 44 i Kushtetutës përcakton se kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

92. E drejta kushtetuese për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar ka si parakusht logjik dhe juridik të saj paligjshmërinë e veprimit dhe mosveprimit të organeve shtetërore. Gjykata vëren se në rastin konkret, DHKN-ja është person juridik i krijuar me ligj, në formën e organizatës profesionale të noterëve që ushtrojnë funksion publik, e cila e siguron buxhetin nga kuotat e anëtarësimit që mblidhen nga çdo noter, si dhe nga burime të tjera të ligjshme (neni 77 i ligjit nr. 110/2018), dhe jo nga buxheti i shtetit. Për rrjedhojë, ajo nuk bën pjesë në organet shtetërore të parashikuara nga neni 44 i Kushtetutës, prandaj Gjykata vlerëson se pretendimi për zhdëmtim nga ana e Bordit Disiplinor nuk bie në fushën e veprimit të kësaj dispozite kushtetuese. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se në respektim të nenit 42 të Kushtetutës noterët gëzojnë në çdo rast të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj vendimit të Bordit Disiplinor.

93. Nga sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkeses, për cenimin e nenit 44 të Kushtetutës, nuk është ngritur në nivel kushtetues.

B.5 Për pretendimin e cenimit të nenit 52 të Kushtetutës

94. Kërkesja në kërkesën e paraqitur ka parashtruar se pika 2 e nenit 31 të ligjit nr. 110/2018 bie ndesh me kriterin e përcaktimit me ligj të sistemit të sigurimeve shoqërore, pasi neni 52 i Kushtetutës nuk lejon që sistemi i pagesës së këtyre kontributeve të përshkallëzohet me ligj të veçantë.

95. Gjatë seancës plenare publike kërkesja ka saktësuar se ky pretendim lidhet me përmbajtjen e pikës 2 të nenit 75 të ligjit nr. 110/2018, që parashikon: *"Paga e zëvendësnoterit nuk mund të jetë më e ulët se 150 % e pagës minimale mujore në shkallë vendi, sipas legjislacionit në fuqi."*

96. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, kanë prapësuar se kërkesja nuk ka sqaruar se cilat janë pasojat e parashikimit ligjor në sistemin e sigurimeve shoqërore. Pika 2 e nenit 75 të ligjit (gabimisht e referuar nga kërkesja në përmbajtje të objektit si pika 2 e nenit 31) parashikon vetëm disa garanci minimale financiare që duhet të ketë zëvendësnoteri gjatë ushtrimit të detyrës së tij dhe nuk përmban asnjë parashikim që të ndërhyjë në sistemin e sigurimeve shoqërore ose në përshkallëzimin e tij. Në pikën 2 të nenit është parashikuar vetëm masa e pagës së zëvendësnoterit, e cila nuk mund të jetë më e ulët se 150% e pagës minimale mujore në shkallë vendi.

97. Subjekti i interesuar, DHKN-ja, për cenimin e nenit 52 të Kushtetutës, ka prapësuar se paga e zëvendësnoterit është vendosur për të siguruar një dysheme për ushtrimin cilësor të veprimtarisë dhe jo për të ndikuar në sistemin e sigurimeve shoqërore.

98. Neni 52 i Kushtetutës parashikon: *"Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj."*

99. Gjykata vëren se pika 2 e nenit 75 të ligjit nr. 110/2018, duke parashikuar masën e pagës minimale mujore të zëvendësnoterit, nuk ndërhyr në sistemin e sigurimeve shoqërore. Për rrjedhojë, në kuptim të parimit *iura novit curia* pretendimin e kërkeses Gjykata do ta trajtojë në këndvështrim të respektimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike, në kuptim të nenit 11 të Kushtetutës, i cili parashikon se sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

100. Gjykata në jurisprudencën e saj e ka interpretuar gjerësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Sipas saj, kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës, etj. Gjykata është shprehur, gjithashtu, se liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet ligjvënësit të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë ose fusha të caktuara (*shih vendimet nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 14, datë 21.3.2014; nr. 24 datë 24.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

101. Për shkak të rolit aktiv të shtetit në drejtim të ushtrimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike, kushtetutëbërësi në nenin 11, paragrafi 3, të Kushtetutës ka parashikuar kriteret mbi bazën e të cilave mund të ndërhyhet për të rregulluar ushtrimin e kësaj lirie, duke përcaktuar: *“Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”*. Pavarësisht këtij kriteri kufizimi, duke qenë se Gjykata e shqyrton pretendimin për cenimin ose jo të kësaj lirie të lidhur ngushtë me sferën e të drejtave të individit, ajo merr në konsideratë edhe përmbajtjen e nenit 17, pika 1, të Kushtetutës, që shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të. Kjo dispozitë, përveç arsyes publike, të cilën e gjejmë edhe te neni 11, pika 3, përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si kufizimi me anë të ligjit dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë (*shih vendimin nr. 89, datë 28.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

102. Nisur nga përmbajtja e pikës 2 të nenit 75 të ligjit nr. 110/2018, Gjykata vëren se kjo dispozitë që parashikon se paga dhe shpërblimet që përfiton zëvendësnoteri përcaktohen në kontratën përkatëse të punës, në pjesën e fundit të saj përcakton edhe pagën mujore të zëvendësnoterit në masën 150 % të pagës minimale mujore në shkallë vendi. Në vlerësimin e Gjykatës, përcaktimi i kësaj mase ndërhyn në të drejtën e palëve për të lidhur kontrata lirisht dhe mbi bazën e vullnetit të tyre personal, prandaj në vijim ajo do të analizojë nëse parashikimi ligjor ngarkon me një barrë të tepruar noterin që bën kërkesë për t’u asistuar nga një zëvendësnoter, sipas kritereve të përcaktuara nga neni 17 i Kushtetutës (*shih paragrafin nr. 57 të vendimit*).

103. Duke qenë se ndërhyrja është bërë nëpërmjet një ligji të miratuar nga Kuvendi dhe nisur nga karakteri publik i funksionit të noterit, ekziston interesi publik që justifikon ndërhyrjen, pasi dispozita ka për qëllim garantimin e cilësisë së shërbimit të zëvendësnoterit, i cili do të kryejë veprimtarinë noteriale në emër dhe për llogari të noterit në rastet e autorizimit prej tij (shkronja “P” e nenit 3 të ligjit nr. 110/2018) dhe, për këtë arsye, Gjykata do të ndalet në proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje.

104. Gjykata vëren se ligji ka përcaktuar disa kritere që noterit të paraqesë kërkesë për t’u asistuar nga një zëvendësnoter, të cilat përfshijnë reputacion të lartë profesional të noterit kërkues dhe një minimum të volumit vjetor të transaksioneve për 3 vjetët paraardhës, që të justifikojnë këtë asistencë (pika 2 e nenit 14). Pra, barra vendoset vetëm tek ata noterë që kanë volum të qëndrueshëm të aktivitetit të tyre. Nga ana tjetër, zëvendësnoteri, sikurse u përmend më lart (*shih paragrafin nr. 44 të vendimit*), mund ta ushtrojë këtë funksion pasi të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për Drejtësi, me diplomë “Master i shkencave” ose diplomë të njësuar me të, si dhe pas kalimit të provimit të kualifikimit, në të cilin ka të drejtë të hyjë pas përfundimit me sukses të formimit fillestar të detyrueshëm 1-vjeçar dhe pas trajnimit praktik 2-vjeçar si kandidat për noter pranë një noterit (pika 1 e nenit 9). Kjo do të thotë se në momentin e ushtrimit të funksionit të zëvendësnoterit, ky i fundit, për shkak të arsimit dhe praktikës së kryer ka një përvojë profesionale të mjaftueshme, që justifikon pagesën mbi pagën minimale në shkallë vendi.

105. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se parashikimi i pikës 2 të nenit 75 të ligjit nr. 110/2018 nuk bie ndesh me kriterin e proporcionalitetit, prandaj pretendimi i kërkueses për antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite është i papabuar.

B.6 Për pretendimin e cenimit të nenit 82 të Kushtetutës

106. Kërkesja ka pretenduar se është cenuar neni 82 i Kushtetutës, pasi ligji nuk është shoqëruar me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Zbatimi i tij do të sjellë barrë financiare të lartë për noterin, pasi ai do të taksohet në mënyrë të dyfishtë si nga shteti, ashtu edhe nga DHKN-ja. Ligji nuk parashikon asnjë organ shtetëror, i cili do të ushtrojë kontroll në përcaktimin dhe destinacionin e shumave që do t'u merren noterëve në formën e kuotave ose pagesave për sistemin NISA nga fitimet e tyre nga veprimtaria e ushtruar.

107. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, kanë prapësuar se pretendimi për cenimin e nenit 82 të Kushtetutës është i pabazuar. Sistemi NISA është krijuar dhe funksionon brenda DHKN-së, kostot, si dhe mënyra e mirëmbajtjes së sistemit janë kompetencë e organeve të saj. Për këtë shkak ligjvënësi nuk ka pasur arsye të kërkonte koston financiare, pasi krijimi i sistemit nuk ndikon drejtpërdrejt në buxhetin e shtetit sikurse kërkon neni 82 i Kushtetutës. Ligji ka parashikuar se DHKN-ja, me miratimin e ministrit të Drejtësisë, miraton rregulla për nivelin e kuotave të anëtarësimit dhe mënyrën e pagesës së tyre, të cilat bazohen në xhiron e veprimtarisë së noterit. Nga ana tjetër, VKM-ja nr. 1045/2020 ka parashikuar se efektet financiare që lidhen me krijimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për zbatimin e saj mbulohen nga DHKN-ja, e cila ka edhe burime të tjera përveç kuotave të anëtarësimit (donacione dhe grante). Kërkesja nuk ka argumentuar se si tarifa për sistemin elektronik, që eventualisht mund të paguhet prej noterëve, ndikon në veprimtarinë ekonomike, e, për rrjedhojë, ajo nuk ka argumentuar në ç'mënyrë mungesa e raportit financiar shoqërues të ligjit ka cenuar interesin e saj.

108. Kushtetuta në nenin 82, parashikon: *“Propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga marrja e projektligjit.”*

109. Gjykata konstaton se neni 82 i Kushtetutës, në thelb, përcakton detyrimin për paraqitjen e raportit që përligj shpenzimet financiare në rastet kur projektligji ndërhyr në financat publike, pra ndikon në buxhetin e shtetit, duke sjellë rritje shpenzimesh ose pakësim të të ardhurave të tij.

110. Duke e vlerësuar ligjin nr. 110/2018 nën dritën e këtij detyrimi, Gjykata konstaton se ai nuk krijon shpenzime në buxhetin e shtetit, pasi kostot dhe mënyra e mirëmbajtjes së sistemit NISA është në ngarkim të buxhetit të DHKN-së. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkeses është i pabazuar.

B.7. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor

111. Kërkesja ka parashtruar se neni 52 i ligjit nr. 110/2018 nuk parashikon garanci procedurale për rastet kur procedimi disiplinor përfundon me masën e pezullimit nga detyra ose heqjen e licencës, pasi ankimi në gjykatë ndaj kësaj mase nuk pezullon zbatimin e vendimit të Bordit Disiplinor.

112. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mospezullimit të ekzekutimit të vendimit të Bordit Disiplinor ndaj një vendimi të padrejtë për pezullimin nga detyra ose heqjen e licencës së noterit, është i pabazuar. Në këtë rast gjen zbatim parimi se akti ekzekutohet dhe nuk pezullohet gjatë gjykimit, me përjashtim të rasteve kur gjykata merr vendim për sigurimin e padisë. Ndërsa, subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se pezullimi i ekzekutimit të aktit është parim që gjen pasqyrim në KPA, prandaj pretendimi për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mospezullimit të ekzekutimit të vendimit të Bordit Disiplinor, në rast të ankimit të tij në gjykatë, nuk ka natyrë kushtetuese.

113. Në nenin 52 të ligjit nr. 110/2018 parashikohet se ministri i Drejtësisë, noteri ose zëvendësnoteri kanë të drejtë të ankimojnë çdo vendim të Bordit Disiplinor për shkelje disiplinore në gjykatën kompetente administrative. Ankimi kundër Bordit Disiplinor nuk pezullon zbatimin e vendimit të ankimuar, deri në shpalljen e vendimit gjyqësor mbi ankimin.

114. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë shqyrtimit të procesit (*shih vendimet nr. 18, datë 30.3.2021; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

115. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se pezullimi i aktit administrativ si një veprim procedural gjyqësor kushtëzohet nga një sërë elementesh që e bëjnë atë të dallueshëm nga pezullimi si pasojë e ankimit administrativ. Në mënyrë të përmblodhur këto elemente janë: ngritja e padisë për shfuqizimin e aktit administrativ; akti duhet të jetë objekt shqyrtimi në referim të dispozitave procedurale përkatëse; në padi të jetë kërkuar shprehimisht pezullimi i zbatimit të tij; të ekzistojnë argumente bindëse për gjykatën se zbatimi i aktit mund të shkaktojë pasoja të pariparueshme ose vështirësisht të riparueshme në rastin e një vendimi eventual që do të shfuqizonte aktin dhe, së fundi, vendimi gjyqësor për pezullim, duhet të arsyetohet (*shih vendimin nr. 32, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

116. Në rastin konkret, Gjykata vëren se dispozita objekt kundërshtimi garanton një ndër elementet më të rëndësishme procedurale të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, atë të ankimit në gjykatë ndaj një akti administrativ. Parimi i pezullimit të aktit administrativ parashikohet në nenin 133 të KPA-së, ku përcaktohet se ankimi administrativ ndaj aktit pezullon ekzekutimin e tij deri në njoftimin e vendimit të ankimit. Në ndryshim nga ky parashikim, në nenin 52 të ligjit nr. 110/2018 parashikohet e drejta e ankimit në rrugë gjyqësore ndaj vendimit të Bordit Disiplinor për masën e pezullimit nga detyra të noterit ose heqjen e licencës dhe në këtë rast ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit të ankimuar deri në shpalljen e vendimit gjyqësor.

117. Gjykata rithekson se kontrolli gjyqësor i akteve me karakter administrativ, duke qenë shprehje e parimit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve e duke qëndruar në themel të pavarësisë së organeve, ka ndryshime thelbësore nga kontrolli administrativ që kryhet në rrugë hierarkike ose nga organe të krijuara posaçërisht. Dallimet qëndrojnë, krahas të tjerave, në rrafshin procedural, në kuptimin që gjykatat në kontrollin e këtyre akteve respektojnë rregullat procedurale përkatëse. Ato nuk mund të interferojnë e as të adaptojnë procedura administrative. Ndër rregullat procedurale, rëndësi paraqet pezullimi i aktit objekt shqyrtimi nga gjykatat si një mundësi procedurale për të mënjeluar krijimin e pasojave negative nga një akt i kontestuar për kundërligjshmëri (*shih vendimin nr. 32, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

118. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se edhe pse ankimi gjyqësor ndaj vendimit të Bordit nuk pezullon automatikisht vendimin për masën disiplinore të marrë prej tij, nuk përjashton mundësinë që pala në çdo rast të kërkojë pezullimin e këtij vendimi në gjykatë, e cila e vlerëson sipas kriterëve ligjorë përkatëse. Prandaj pretendimi i kërkuarës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor është i pabazuar.

C. Për pretendimin për shfuqizimin e VKM-së nr. 1045/2020

119. Kërkuarja ka pretenduar se VKM-ja nr. 1045/2020 cenon parimin e sigurisë juridike, pasi është haptazi në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9880/2008, që përcakton se nënshkrimi elektronik nuk mund të përdoret në veprimet juridike në fushat e së drejtës familjare dhe të së drejtës së trashëgimisë, të cilat u nënshtrohen kërkesave të veçanta ligjore, si dhe në veprime të tjera juridike, të cilat kërkojnë legalizim publik, një akt noterial ose një autorizim nga gjykata.

120. Kërkuarja ka parashtruar se edhe VKM-ja nr. 1045/2020 bie në kundërshtim me nenin 35 të Kushtetutës, pasi cenohet mbrojtja e të dhënave personale. Sipas saj, krijimi dhe funksionimi i sistemit NISA nuk është bërë në përputhje me ligjin nr. 10325/2010. DHKN-ja, si institucioni administrues i të dhënave nuk legjitimohet në këtë funksion, pasi të dhënat shtetërore duhet të administrohen nga një person publik ose privat që ushtron funksione publike (shkronja

“b”, pika 1, neni 2 e ligjit nr. 10325/2010) dhe DHKN-ja nuk ushtron funksion publik. Gjithashtu, cenohen interesat e noterëve, pasi ky akt sjell kosto shtesë për noterët dhe rrjedhimisht një taksë të fshehur, e cila ndikon në parimin e lirisë ekonomike dhe në sistemin tatimor. Noterët duhet të përpilojnë aktet noteriale, të nënshkruajnë elektronikisht, t'i regjistrojnë ato në sistemin NISA, si dhe të paguajnë tarifa dhe kosto të papërcaktuara në ligj dhe të paqarta për mënyrën se si do të përcaktohen. Ndërkohë që ekziston sistemi elektronik RNSH, i miratuar me VKM-në nr. 304/2014, ku veprimet noteriale kryhen pa asnjë tarifë shtesë. Të gjitha ndërlihdhet që parashikon VKM-ja nr. 1045/2020, noteri i siguron pa kosto nëpërmjet sistemit *e-Albania* dhe ndërlihdhet së siguar nga ASHK-ja.

121. Kërkesja ka parashtruar pretendime edhe për momentin e botimit në Fletoren Zyrtare të VKM-së nr. 1045/2020, pasi ajo është miratuar në datën 15.1.2020 dhe është botuar në datën 4.2.2021. Ndërkohë, kanë dalë urdhra të ministrit të Drejtësisë që rregullojnë aspekte të funksionimit të sistemit përpara hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 1045/2020, që ka ligjëruar këtë bazë të dhënash.

122. Subjekti i interesuar, Kuvendi, gjatë seancës plenare ka prapësuar se megjithëse në parashtrimet me shkrim është shprehur edhe për VKM-në në fjalë, si organ ligjvënës, u qëndron vetëm argumenteve në lidhje me kundërshtimin e dispozitave të ligjit nr. 110/2018.

123. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se RNSH-ja dhe sistemi “NISA” janë dy baza të dhënash që nuk janë ngritur për të njëjtin qëllim. RNSH-ja është krijuar për hedhjen e të dhënave lidhur me veprimtarinë noteriale në funksion të realizimit të ushtrimit të veprimtarisë së ministrit të Drejtësisë në fushën e mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit të noterit në përputhje me ligjin. Ndërsa NISA ka si qëllim mirëfunksionimin dhe menaxhimin e të gjithë veprimtarisë noteriale. Duke synuar që nëpërmjet ndërveprimit me regjistrat elektronikë publikë, sistemet informatike të Ministrisë, agjencive të tjera dhe sistemit bankar, të merret i gjithë informacioni i nevojshëm për hartimin e aktit noterial.

124. Subjekti i interesuar, DHKN-ja, ka argumentuar se VKM-ja e vendos Ministrinë e Drejtësisë në rolin e monitoruesit/inspektuesit të shërbimit noterial. Nëpërmjet sistemit sigurohet që çdo akt noterial do të numërohet me një numër unik identifikues; arkiva dokumentare dhe elektronike e çdo zyre noteriale do të jenë të njëjta; nuk do të qarkullojë asnjë dokument noterial, përveç dokumenteve të arkivuara në sistemin NISA; gjenerimi i faturës nga sistemi do të sigurojë aplikimin vetëm për tarifat e shërbimeve të miratuara; mundësi raportimi për strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe akses në çdo kohë dhe për çdo kërkesë specifike nga këto struktura.

125. Gjykata vëren se edhe pse kërkesja pretendon se VKM-ja nr. 1045/2020 cenon parimin e sigurisë juridike, mbrojtjen e të dhënave personale dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, në thelb, pretendimet e saj, sikurse shpjegoi edhe gjatë seancës plenare, janë të lidhura me cenimin e parimit të sigurisë juridike. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse përmbajtja e VKM-së bie ndesh me këtë parim (*shih paragrafin nr. 73 të vendimit*).

126. Gjykata vëren se para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 110/2018, me VKM-në nr. 304/2014, bazuar në ligjin tashmë të shfuqizuar nr. 7829/1994 “Për noterinë”, është vendosur krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të Shërbimit Noterial Shqiptar, të quajtur RNSH. Nga përmbajtja e kësaj VKM-je konstatohet se subjekt përgjegjës për administrimin, auditimin, zhvillimin e RNSH-së është Ministria e Drejtësisë (shkronja “a” e pikës 5), kurse DHKN-ja është institucioni përgjegjës në proceset e noterisë (shkronja “b” e pikës 5). Institucionet që konsiderohen si dhënëse të informacionit janë: noterët, Ministria e Drejtësisë, palët, individët dhe subjektet fizike e juridike (pika 6). Në pikën 8 të VKM-së nr. 304/2014 është përcaktuar niveli i aksesit të noterëve dhe DHKN-së në sistemin dhe bazën e të dhënave të RNSH-së, të cilët kanë të drejtë leximi vetëm për të dhënat e tyre në regjistrat e akteve dhe veprimeve noteriale, në të dhënat dytësore për komunikim, kanë të drejtë modifikimi ose anulimi vetëm për aktet/veprimet që nuk janë arkivuar, kanë të drejtë leximi në regjistrin e testamenteve, por nuk kanë të drejtë për të parë dokumentin dhe tekstin e tij. Ndërsa Ministria e Drejtësisë ka të drejta të plota në rolin e administratorit, raportuesit, audituesit dhe zhvilluesit. Ndërkohë, në pikën 9 të VKM-së

përcaktohet se ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, proceset elektronike të punës në RNSH, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

127. Nga ana tjetër, sistemi i ri NISA është krijuar nga ligji nr. 110/2018, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin nr. 75 të vendimit*), për t'iu përgjigjur zhvillimeve teknologjike dhe situatës aktuale shoqërore për digjitalizim. Ligji nr. 110/2018 e ka lënë në kompetencë të DHKN-së krijimin dhe administrimin e sistemit, me qëllim prodhimin dhe regjistrimin e dokumenteve noteriale, si dhe menaxhimin e veprimtarisë noteriale kombëtare (shkronja “dh” e nenit 81 të ligjit nr. 110/2018), por edhe përcaktimin e tarifave përkatëse që do të paguheshin nga noterët (shkronja “e” e nenit 81 të ligjit nr. 110/2018). Ndërsa VKM-ja nr. 1045/2020 siguron vetëm ndërveprimin e sistemit NISA me sistemet informatike të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të institucioneve të tjera shtetërore publike ose private.

128. Konkretisht, VKM-ja nr. 1045/2020 siguron ndërlidhjen e sistemit NISA me Regjistrin Kombëtar të Zyrës së Gjendjes Civile, Regjistrin Publik të Pasurive të Paluajtshme, Regjistrin e Barrëve Siguruese, Regjistrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe me sistemet informatike të agjencive shtetërore/publike ose private e të sistemit bankar. NISA dërgon për regjistrim, në kohë reale, në sistemin elektronik të RNSH-së të dhënat për aktet noteriale, për veprimet noteriale, dokumentet e nënshkruara elektronikisht nga noteri, të dhënat e testamenteve, dokumentet e skanuara të akteve dhe veprimeve noteriale, të dhënat për palët, individë dhe subjekte, informacione të tjera plotësuese për procese të punës së noterëve (pika 13 e VKM-së nr. 1045/2020).

129. Gjykata vlerëson se të dyja sistemet, përveçse administrohen nga institucione të ndryshme, edhe nga mënyra e funksionimit nuk e zëvendësojnë njëra-tjetrën. Sikurse rezultoi gjatë seancës plenare, sistemi RNSH konsiston në regjistrimin nëpërmjet skanimit të aktit të krijuar nga noteri, pra të çdo të dhëne që përmban akti, duke funksionuar si një arkiv aktesh. Të gjithë të dhënat e tjera që i nevojiten noterit sigurohen nëpërmjet portalit *e-Albania*. Nisur nga këto funksione sistemi RNSH administrohet nga Ministria e Drejtësisë, pasi është një instrument në kuadër të veprimtarisë së ministrit të Drejtësisë në fushën e mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit të noterit në përputhje me ligjin (pika 18/1 e nenit 6 të ligjit nr. 8678/2001). Ndërsa sistemi NISA, në funksion të saktësisë dhe integritetit të veprimeve dhe akteve noteriale, ka për qëllim garantimin e të dhënave të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, duke synuar që nëpërmjet ndërveprimit me regjistrat elektronikë publikë dhe sistemet informatike të Ministrisë, agjencive të tjera e sistemit bankar, të merret informacioni i duhur për hartimin e aktit noterial, pa pasur nevojë për përdorimin e sistemeve/portaleve të tjera. Për këtë arsye ky sistem, për të garantuar pavarësinë e organizimit të noterëve, i është lënë në administrim DHKN-së, e cila është dhe organizata profesionale, e krijuar me ligj, që mbrohet interesat e tyre. Fakti, i evidentuar gjatë seancës plenare, se sistemi administrohet nga një subjekt privat, i përzgjedhur nga DHKN-ja në bazë të një procedure të njëjtë me atë të prokurimit që zhvillohet nga institucionet publike për të përfituar një shërbim të caktuar, nuk përbën argument të nivelit kushtetues, pasi lidhet me zbatueshmërinë e ligjit dhe për rrjedhojë i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

130. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se përmbajtja e VKM-së nr. 1045/2020 nuk paraqet paqartësi në formulim për mënyrën e ndërveprimit të sistemit NISA me sistemet informatike të Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të tjera shtetërore publike ose private, si dhe ka kuptueshmëri të mjaftueshme për të shmangur arbitraritetin në zbatimin e saj.

131. Për sa i përket pretendimit të kërkuarës se VKM-ja nr. 1045/2020 bie ndesh me ligjin nr. 10325/2010 dhe se DHKN-ja nuk ka funksion publik dhe nuk mund të administrojë sistemin NISA, në thelb, argumentet e saj lidhen me përplasjen ndërmjet akteve nënligjore dhe dispozitave të tjera ligjore, të cilat, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin nr. 78 të vendimit*), nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

132. Nga ana tjetër, Gjykata në jurisprudencën e saj ka çmuar se kuptimi mbi legjitimitimin e shoqatave duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për

cenim të një të drejte substanciale kushtetuese që ka lidhje me interesat e tyre dhe pretendimeve për antikushtetutshmëri të aktit nënligjor të kundërshtuar, në kuptim të rregullimeve kushtetuese procedurale, për të cilat mund t'i drejtohen Gjykatës subjektet e kushtëzuara sipas nenit 134 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2014; nr. 17, datë 27.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

133. Edhe pse nga kërkuesja nuk është pretenduar ekzistenca e veseve formale të aktit, Gjykata vlerëson të theksojë se shfuqizimi i fjalisë së fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018, si pasojë e cenimit të parimit të sigurisë juridike, nuk cenon rregullat e parashikuara në VKM-në nr. 1045/2020, pasi nuk lidhen me dispozitën e sipërcituar.

134. Ndërsa në lidhje me pretendimin për momentin e botimit të VKM-së në Fletoren Zyrtare, dhe daljes të urdhrave të ministrit të Drejtësisë, që rregullojnë aspekte të funksionimit të sistemit përpara hyrjes në fuqi të saj, kërkuesja, e pyetur edhe në seancë plenare, nuk arriti të identifikojë asnjë akt nënligjor të dalë para hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 1045/2020. Gjithashtu, nga ana tjetër, Gjykata konstaton se nuk rezulton të jenë miratuar urdhra dhe udhëzime në zbatim të VKM-së nr. 1045/2020, para hyrjes në fuqi të saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues për të provuar pretendimin se botimi i VKM-së nr. 1045/2020 pas një viti nga momenti i miratimit ka sjellë pasoja në drejtim të cenimit të të drejtave të noterëve.

C. Për pezullimin sipas objektit të kërkesës

135. Kërkuesja ka parashtruar se duhet të pezullohet zbatimi i shkronjave “d” dhe “dh” të pikës 2 të nenit 26, si dhe i neneve 41-53 të ligjit nr. 110/2018, pasi krijimi i një bordi disiplinor sjell mbivendosje me kompetencat e ministrit të Drejtësisë dhe bën të pamundur rifitimin në kohë të arsyeshme të të drejtave të noterëve në rast se do të merren vendime nga ky bord sipas procedurave të këtij ligji. Noterët duhet të përdorin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre sistemin NISA, por me VKM-në nr. 304/2014 është miratuar sistemi RNSH, ku regjistrohen të gjitha aktet noteriale pa asnjë kosto financiare për noterët. Sistemi NISA, në praktikë, kërkon një investim të ri në pajisje, në fuqi punëtore, sepse përpilimi i një akti zgjatet dukshëm në kohë. Hedhja e të dhënave nga noteri në këto dy sisteme është në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 10325/2010 dhe nenin 7 të ligjit nr. 9880/2008, e, për rrjedhojë, zbatimi i këtyre dispozitave do ta vendoste noterin në pozita paligjshmërie. Gjithashtu, sipas kërkueses, nenet 95, 96 dhe 106 të ligjit nr. 110/2018 duhet të pezullohen, pasi cenojnë interesat e noterëve, të cilët duhet të paguajnë tarifa dhe kosto të papërcaktuara në ligj dhe të paqarta për masën dhe mënyrën e përcaktimit të tyre.

136. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, kanë prapësuar se kërkesa për pezullim është e pabazuar, pasi, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesja nuk e ka shoqëruar këtë kërkim me argumente konkrete lidhur me pasojat e rënda dhe të pariparueshme që vijnë për noterët nga zbatimi i mëtejshëm i ligjit dhe VKM-së.

137. Gjykata, bazuar në nenin 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare, urdhëron pezullimin e tij.

138. Gjykata ka theksuar se një nga kushtet që kërkohet për të vendosur pezullimin e veprimit të mëtejshëm të akteve objekt shqyrtimi është që pasojat të jenë në realizim e sipër në momentin kur çështja ndodhet para Gjykatës, pra të jenë reale dhe jo potenciale. Gjithashtu, kërkohet që pasojat që vijnë nga zbatimi i mëtejshëm i aktit të jenë të rënda dhe të pariparueshme. Nuk mjafton vetëm fakti i ardhjes së pasojave të padëshirueshme ose ekonomikisht të pafavorshme apo i pasigurisë juridike që mund të rrjedhë nga zbatimi i aktit. Më së shumti kërkohet që zbatimi i tij të sjellë pasoja juridike të rënda që shkojnë tej masës normale të kufizimit (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 29, datë 2.7.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

139. Gjykata, pasi mori në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesja në lidhje me kërkesën për pezullim dhe dëgjoi palët pjesëmarrëse në gjykim, në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.

8577/2000, vlerësoi se, edhe pse e ka shfuqizuar fjalinë e fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018, ajo nuk sjell efekte të menjëhershme dhe të pariparueshme në të drejtat e noterëve deri në hyrjen në fuqi të vendimit të saj. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim².

140. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga shoqata “Unioni i Noterëve Shqiptarë” është pjesërisht e bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja “d”, 51/a, pika 1, shkronja “b” dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e fjalisë së fundit të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.
3. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.10.2021

Shpallur më 19.11.2021

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Elsa Toska, Altin Binaj, Përparim Kalo, Fiona Papajorgji

Anëtarë pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të kërkesës së paraqitur nga shoqata “Unioni i Noterëve Shqiptarë” (*kërkesja*), me të cilën është kërkuar shfuqizimi i disa dispozitave të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” (*ligji nr. 110/2018*) dhe i VKM-së nr. 1045, datë 15.1.2020 “Për mënyrën e ndërlidhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave” (*VKM nr. 1045/2020*), jemi pjesërisht kundër qëndrimit të shumicës. Qëndrimi ynë kundër lidhet vetëm me dy prej pretendimeve të kërkuësës, për të cilat vlerësojmë se janë të bazuara dhe duhen pranuar, më konkretisht:

a) Ndalimi i caktimit apo emërimit pranë noterit të bashkëshortit ose të afërmit të tij deri në shkallë të dytë, si kandidat për noter apo si zëvendësnoter, që parashikohet në nenet 8, pika 2 dhe 15, pika 4, të ligjit nr. 110/2018 krijon diskriminim të padrejtë, për rrjedhojë këto dispozita ligjore duhen shfuqizuar.

b) Rregullat për mënyrën e ndërlidhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave, të parashikuara në VKM-në nr. 1045/2020, nuk respektojnë parimin e sigurisë juridike me pasojë cenimin e së drejtës kushtetuese të mbrojtjes së të dhënave personale, për rrjedhojë ky akt normativ duhet shfuqizuar tërësisht.

2. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin

² Gjyqtarja S. Bejtja votoi për pezullimin e VKM-së nr. 1045/2020.

përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër pjesërisht.

4. Për antikushtetutshmërinë e neneve 8, pika 2 dhe 15, pika 4, të ligjit nr. 110/2018

3. Kërkesja ka pretenduar se këto dispozita ligjore bien ndesh me lirinë e zgjedhjes së profesionit dhe të vendit të punës, të parashikuar në nenin 49 të Kushtetutës, si dhe me parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës. Mohimi i së drejtës së bashkëshortit dhe të afërmeve, për shkak të lidhjes gjinore me noterin, për të konkurruar nuk bazohet tek interesi publik, si dhe nuk përmban ndonjë arsye të përligjur dhe objektive për të justifikuar diskriminimin e tyre.

4. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se diferencimi i të afërmeve të noterit nga shtetasit e tjerë, i parashikuar në ligj, është i përligjur dhe për arsye objektive, pasi i shërben procesit cilësor të pranimit në formimin fillestar, bazuar në parimin e meritokracisë dhe barazisë para ligjit, duke shmangur çdo ndikim politik, miqësor, nepotik ose trashëgiminë e profesionit, si dhe duke parandaluar abuzimet dhe korrupsionin në licencim.

5. Në të njëjtën linjë me shumicën i qëndrojmë konstatimit se pretendimi i kërkeses për këto dispozita ligjore duhet vlerësuar në drejtim të cenimit të parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës (*shih paragrafin nr. 36 të vendimit*), në marrëdhëniet e punësimit. Po ashtu, ne bashkohemi me shumicën, për sa u takon standardeve që gjejnë zbatim për vlerësimin e këtij pretendimi dhe detyrimit që rëndon mbi organin ligjvënës për t'iu përmbajtur këtij parimi (*shih paragrafin nr. 40 të vendimit*). Me të njëjtin arsyetim si shumica (*shih paragrafin nr. 41 të vendimit*), ne arrijmë në përfundimin se dispozitat ligjore të kundërshtuara vendosin një diferencim të kandidatit për noter dhe zëvendësnoterit për shkak të lidhjeve gjinore.

6. Ajo që na ndan me shumicën lidhet me vlerësimin nëse dispozitat ligjore të kundërshtuara respektojnë kriteret e pikës 3 të nenit 18 të Kushtetutës, pra nëse ekziston një përligjeje e arsyeshme dhe objektive e diskriminimit të familjarëve të noterit në marrëdhëniet e punësimit.

7. Në këtë pikë shumica ka konkluduar se pretendimi i kërkeses nuk është i bazuar, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se *“ligjvënësi nëpërmjet kriterëve të përcaktuar në dispozitat në shqyrtim ka synuar të garantojë barazinë midis të gjithë kandidatëve për noter dhe zëvendësnoter, me qëllim vlerësimin objektiv të tyre në marrjen e njohurive dhe aftësive të përshtatshme për të gjitha aspektet e veprimtarisë noteriale, për të shmangur dyshimin e arsyeshëm për vlerësime subjektive, në kushtet e konfliktit të interesit ose lidhjes së kontratave fiktive me zëvendësnoterët. Vlerësimi objektiv për aftësitë profesionale të kandidatëve për noter nga ana e noterit përgjegjës, bazuar në meritokraci dhe barazi para ligjit, shmang nepotizmin në profesionin e noterit. Gjithashtu, ushtrimi efektiv i profesionit nga ana e zëvendësnoterit garanton fitimin e aftësive të nevojshme për kryerjen më pas të detyrës së noterit”* (*shih paragrafin nr. 46 të vendimit*).

8. Në ndryshim nga shumica, ne vlerësojmë se gjatë gjykimit të çështjes nuk u konstatua ekzistenca e një përligjeje të arsyeshme dhe objektive, që të justifikojë diskriminimin e të afërmeve të noterit nga dispozitat e kundërshtuara. Ky vlerësim mbështetet në argumentet e parashtruara në vijim.

9. Argumenti i parë buron nga analiza krahasimore e ndryshimeve ligjore. Dispozitat e kundërshtuara nga kërkesja kanë ndryshuar regjimin e mëparshëm të përcaktuar në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar (*ligji nr. 7829/1994*), sipas të cilit për licencimin si noter, ndër të tjera, mjaftonte që kandidati të kishte punuar jo më pak se 2 vjet si asistent pranë një noterit e më pas të kalonte me sukses provimin e kualifikimit. Plotësimi i vendit vakant që krijohej për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, plotësimi të moshës 65 vjeç ose vdekjes së noterit, i ofrohej nga ministri i Drejtësisë bashkëshortes/bashkëshortit ose fëmijëve të tij/saj, nëse ata fitonin mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtronin profesionin e noterit³.

³ Neni 22 i ligjit nr. 9216, datë 1.4.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 ‘Për noterinë’, i ndryshuar me ligjin nr. 8790, datë 10.5.2001”.

10. Nga një vështrim krahasimor konstatohet lehtësisht se ligjvënësi, jo vetëm që ka shfuqizuar përparësinë në licencim që i jepej kandidatëve në gjini të afërt me noterin, por ka avancuar edhe më tej, duke vendosur ndalim të shprehur për kandidatët që procesin përgatitor të licencimit (kandidat për noter dhe zëvendësnoter) ta zhvillojnë pranë noterit me lidhje bashkëshortore ose të afërt gjer në shkallë të dytë.

11. Për rrjedhojë, është më se e qartë se nëse ligjvënësi do të ishte mjaftuar vetëm me shfuqizimin e regjimit të mëparshëm ligjor, atëherë do të përmbushej qëllimi i deklaruar nga subjektet e interesuara si përligjeje e arsyeshme dhe objektive, konkretisht *“për të pasur një proces cilësor të pranimi në formimin fillestar, bazuar në parimin e meritokracisë dhe barazisë para ligjit duke shmangur çdo ndikim politik, miqësor, nepotik ose trashëgiminë e profesionit, si dhe duke parandaluar abuzimet dhe korrupsionin në licencim”*. Thënë ndryshe, ligji nr. 110/2018, pa praninë e neneve 8, pika 2 dhe 15, pika 4, garanton barazinë e të gjithë shtetasve para ligjit për t’u emëruar zëvendësnoterë ose licencuar noterë, pasi të afërmit e noterit nuk kanë asnjë përparësi të caktuar nga ligji.

12. Një argument tjetër lidhet me situatën e konfliktit të interesave, eliminimi i së cilës në parim përbën përligjeje të arsyeshme dhe objektive. Për këtë qëllim nevojitet analiza e rolit që ligji i ka caktuar noterit përgjegjës në raport me kandidatin për noter ose zëvendësnoterin.

13. Në parantezë duhet shpjeguar se ligji nr. 110/2018 e ka konceptuar licencimin e noterit si proces që kalon në disa faza (nenet 3, 5, 6, 7, 8, 9, 13 dhe 15). Faza e parë është kandidimi për noter, në të cilën i interesuari kryen formimin fillestar dhe trajnimin praktik pranë noterit përgjegjës, duke iu nënshtruar në përfundim provimit të kualifikimit. Kandidati për noter që kalon me sukses provimin e kualifikimit fillon fazën e dytë, që konsiston në ushtrimin e funksionit të zëvendësnoterit, pas emërimit nga ministri i Drejtësisë. Zëvendësnoteri ka të drejtë të kërkojë të licencohet si noter nëse ka ushtruar detyrën e zëvendësnoterit për të paktën 3 vjet.

14. Ligji nr. 110/2018 parashikon një marrëdhënie pune midis noterit, nga njëra anë, dhe kandidatit për noter ose zëvendësnoterit, nga ana tjetër. Në rastin e kandidatit për noter, noteri përgjegjës vlerëson punën e tij për çdo vit kalendarik (neni 8), por ligji nuk parashikon asnjë ndikim të këtij vlerësimi përgjatë procesit të licencimit si noter, përkundrazi ligji e ka lidhur këtë proces me kushtin e kalimit me sukses të provimit të pranimi fillestar, të organizuar nga Qendra e Trajnimit të Dhomës Kombëtare të Noterisë (neni 6) dhe të provimit të kualifikimit për noter, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë (neni 9). Ndërsa në rastin e zëvendësnoterit, të drejtat dhe detyrimet përcaktohen shprehimisht në ligj (neni 66), ku nuk parashikohet asnjë akt vlerësimi pune prej noterit dhe për më tepër, licencimi si noter lidhet me vjetërsinë në detyrën e zëvendësnoterit dhe shfaqjen e interesit të tij për vendet vakante (neni 13).

15. Në ndryshim të vlerësimit që shumica i ka bërë arsyeshmërisë së mjetit të zgjedhur nga ligjvënësi – pra, ndalimit të ushtrimit të detyrave pranë noterit me lidhje familjare (*shih paragrafin nr. 46 të vendimit*), çmojmë se aftësitë në punë të kandidatit për noter/zëvendësnoterit në fund të procesit në çdo rast testohen nga provimi i kualifikimit ose edhe më tej, nga kontrollet/inspektimet që kryhen nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë ose të DHKN-së. Cilësia e aftësive profesionale të kandidatit për noter ose zëvendësnoteri nuk mundet t’i atribuohet për shkak të ligjit lidhjeve gjinore të tij me noterin, pranë të cilit ushtron veprimtarinë. Aftësitë profesionale nuk janë gjë tjetër veçse mundësia e përmbushjes së detyrës dhe dhënia e rezultatit të duhur, duke respektuar kohën, energjinë dhe burimet në dispozicion. Si të tilla, ato kanë natyrë individuale dhe lidhen në mënyrë të ngushtë dhe të qenësishme me karakterin dhe vullnetin e vetë kandidatit për noter/zëvendësnoteri. Për pasojë, mjeti ligjor i gjetur nga ligjvënësi është i pakuptimtë për të dhënë efektin e deklaruar në seancë plenare nga subjektet e interesuara, konkretisht *“për të pasur një proces cilësor të pranimi në formimin fillestar, bazuar në parimin e meritokracisë dhe barazisë para ligjit duke shmangur çdo ndikim politik, miqësor, nepotik ose trashëgiminë e profesionit, si dhe duke parandaluar abuzimet dhe korrupsionin në licencim”*.

16. Nën këtë analizë, vlerësojmë se në marrëdhënien e punës, të parashikuar nga ligji nr. 110/2018 midis noterit, nga njëra anë, dhe kandidatit për noter ose zëvendësnoterit, nga ana tjetër, nuk ka mundësi të krijohet situata e konfliktit të interesit, me pasojë në procesin e

licencimit. Duhet evidentuar se tashmë në Shqipëri koncepti i konfliktit të interesave jo vetëm që parashikohet prej vitesh nga legjislacioni, por edhe institucionet kanë qëndrim të konsoliduar në zbatimin praktik të tij. Ky koncept përkufizohet si gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të zyrtarit, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Konflikti i interesave është i lidhur me detyrën publike, në kuptimin që personi në fjalë duhet të ketë funksion publik dhe/ose të ketë rol thelbësor e përcaktues në vendimarrjen për një akt të caktuar. Ekzistenca e konfliktit të interesit vlerësohet në raport me momentet përcaktuese të vendimarrjes, sikurse janë: çasti i fundit i procesit vendimarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit; çasti paraprak i vendimarrjes, i cili është thelbësisht i rëndësishëm dhe përcaktues për përmbajtjen përfundimtare të aktit; ose kur pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i funksionarit publik në vendimarrjen për aktin përcaktojnë përmbajtjen e tij.

17. Për sa më lart, në kushtet kur noterit përgjegjës në çdo fazë të procesit të licencimit të noterëve të tjerë, duke përfshirë edhe emërimin e zëvendësnoterit, i mungon kompetenca vendimarrëse, qoftë edhe ajo paraprake, si dhe kur ndikimi, pjesëmarrja ose qëndrimi i tij nuk ka asnjë peshë dhe vlerë në këtë proces, atëherë ekzistenca e konfliktit të interesit, qoftë edhe në dukje, përjashtohet, duke mbetur e pakuptimtë për t'u konsideruar. Për rrjedhojë, është haptazi i pabazuar qëllimi i deklaruar nga subjektet e interesuara si përligje e arsyeshme dhe objektive e diskriminimit të të afërmeve të noterit nga dispozitat e kundërshtuara, konkretisht *“për të pasur një proces cilësor të pranimit në formimin fillestar, bazuar në parimin e meritokracisë dhe barazisë para ligjit duke shmangur çdo ndikim politik, miqësor, nepotik ose trashëgiminë e profesionit, si dhe duke parandaluar abuzimet dhe korrupsionin në licencim”*.

18. Në shtesë të argumenteve të mësipërme duhet theksuar se një qasje ndaluese e tillë nuk është ndjekur në mënyrë uniforme nga ligjvënësi brenda të njëjtit ligj. Për ilustrim shërben neni 66, pika 6, i ligjit nr. 110/2018, sipas të cilit zëvendësnoteri mund të punësohet nga DHKN-ja si menaxher ose asistent i Kryetarit dhe/ose Këshillit të Dhomës, pasi ka punuar në zyrë noteri si zëvendësnoter për jo më pak se një vit dhe në këtë rast koha e punësimit të tij në DHKN do të llogaritet në përvojën e tij profesionale kur ai të shprehë interesin për një vend vakant si noter. Siç konstatohet lehtësisht, në këtë rast nuk është vendosur ndalim për të afërmit e kryetarit të DHKN-së ose të anëtarëve të Këshillit të Dhomës, që tregon se ligjvënësi nuk është treguar koherent brenda të njëjtit ligj, në kuptimin që situata të njëjta t'i rregullojë në mënyrë të njëjtë për të njëjtin qëllim ose thënë ndryshe, për shkak të mungesës së koherencës në këtë drejtim, ka lënë hapësirë për krijimin e arbitraritetit në formën e ligjit.

19. Shmangia e konfliktit të interesit në procesin e licencimit të noterit, e parashtruar nga subjektet e interesuara dhe e përkrahur nga shumica, nuk përbën përligje të arsyeshme dhe objektive edhe për një argument tjetër. Në rrethin e të afërmeve ligji ka përfshirë vetëm anëtarë të familjes së ngushtë gjer në shkallë të dytë, duke lënë mundësinë që në këto pozicione të përfshihen të afërm të tjerë gjer në shkallë të katërt⁴, siç janë bashkëjetuesi, ungjërit, emtat ose fëmijët e vëllezërve dhe të motrave apo individë me lidhje miqësore të ngushta, ose me interesa personale të drejtpërdrejt. Në këtë pikëpamje nuk duhet lënë mënjanë fakti që Shqipëria është një vend me popullsi të vogël, në të cilin tradita e bazuar në lidhjet familjare të ngushta është e konsoliduar në atë masë që tejkalon shkallën e gjinisë së afërt të caktuar nga ligji.

20. Në përmbyllje të argumenteve, çmojmë të rëndësishme të theksojmë se në gëzimin e së drejtës për punë, siç është trajtuar edhe më herët nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, diskriminimi, në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, për shkak të lidhjeve nepotike, mund të lejohet vetëm nga rregullime të arsyeshme që mund t'u atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme. Situata ndryshon kur shteti drejtohet për të kontrolluar kushtet objektive të

⁴ Për mënyrën e përcaktimit të shkallëve të gjinisë dhe krushqisë shih vendimin nr. 00-2013-897 (219), datë 28.3.2013 të Gjykatës së Lartë.

pranimit në një vend pune. Në këto raste, kufizimet janë të lejueshme vetëm në terma shumë të ngushtë dhe të përcaktuar. Përgjithësisht, ligjvënësi mund të vendosë kushte të tilla vetëm kur ato nevojiten për të treguar rreze jashtëzakonisht shumë të mundshme për interesa me rëndësi thelbësore të komunitetit (*shih vendimin nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Si përfundim, për të gjitha argumentet e parashtruara më lart, vlerësojmë se subjektet e interesuara dështuan të justifikojnë në mënyrë bindëse në gjykim se diskriminimi i bashkëshortit dhe të afërmeve gjer në shkallë të dytë të noterit në marrëdhëniet e punës, i bërë nga ligji, bazohet në një përligje të arsyeshme dhe objektive. Për rrjedhojë, nenet 8, pika 2 dhe 15, pika 4 të ligjit nr. 110/2018 bien ndesh me nenin 18 të Kushtetutës dhe, si të tilla, duhet të ishin shfuqizuar.

B. Për antikushtetutshmërinë e VKM-së nr. 1045/2020

22. Kërkuesja ka pretenduar se VKM-ja nr. 1045/2020 cenon parimin e sigurisë juridike, pasi bie ndesh me disa ligje, ndër të tjera edhe ligji nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” (*ligji nr. 10325/2010*), si dhe cenon të dhënat personale, mbrojtja e të cilave garantohej nga neni 35 i Kushtetutës. Po ashtu, sipas kërkueses, sistemi elektronik NISA është krijuar dhe regjistruar nga DHKN-ja që në vitin 2017, ndërkohë që ligji nr. 110/2018 është miratuar në vitin 2018 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2019. Për më tepër, kjo VKM, ndonëse është miratuar në datën 15.1.2020, është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 4.2.2021, pra pas një viti.

23. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se RNSH-ja dhe sistemi NISA janë dy baza të dhënash që nuk janë ngritur për të njëjtin qëllim dhe se sistemi NISA ka si qëllim mirëfunksionimin dhe menaxhimin e të gjithë veprimtarisë noteriale.

24. Shumica, pas shqyrtimit të pretendimit të kërkueses dhe prapësimeve të subjekteve të interesuara, ka vlerësuar, në mënyrë të përmbledhur, se përmbajtja e VKM-së nr. 1045/2020 nuk paraqet paqartësi në formulim në drejtim të mënyrës së ndërveprimit të sistemit NISA me sistemet informatike të Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të tjera shtetërore publike ose private, si dhe ka kuptueshmëri të mjaftueshme për të shmangur arbitraritetin në zbatimin e saj (*shih paragrafin nr. 130 të vendimit*). Pretendimi se kjo VKM bie ndesh me një numër ligjesh dhe se DHKN-ja nuk ka funksion publik e nuk mund të administrojë sistemin NISA, ka të bëjë me përplasjen ndërmjet akteve nënligjore dhe dispozitave të tjera ligjore, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafin nr. 131 të vendimit*). Ndërsa, për sa i përket pretendimit për vonesën e botimit të VKM-së, kërkuesja nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues për të provuar pretendimin se botimi i vonuar ka cenuar të drejtat e noterëve (*shih paragrafin nr. 134 të vendimit*).

25. Në ndryshim nga shumica, çmojmë se VKM-ja nr. 1045/2020 duhet shfuqizuar në tërësi, pasi ajo krijon pasiguri juridike në atë masë, që sjell pasoja për cenimin e të dhënave personale, mbrojtja e të cilave garantohej nga neni 35 i Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton, ndër të tjera, se askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhënat që lidhen me personin e tij dhe se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Ky vlerësim bazohet në argumentet e mëposhtme.

26. Duhet vënë re se ligji nr. 110/2018 trajton sistemin elektronik që krijohet dhe administrohet nga DHKN-ja, në kuptimin e një arkivi qendror elektronik, që është në shërbim të të gjithë noterëve që ushtrojnë veprimtari profesionale në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbledh të gjitha aktet noteriale të përpiluara. Po ashtu, koncepti ligjor i sistemit elektronik përfshin edhe mundësinë e qasjes së noterit në regjistra të tjerë elektronikë publikë, me qëllim marrjen e informacionit prej tyre, të nevojshëm për përpilimin e akteve noteriale. Qasja e noterit dhe aplikimi për informacion duhet të garantojë rregullat e ligjit për bazën e të dhënave shtetërore (nenet 63 shkronja “ll”, 67, 81, shkronja “dh”, 96, 106, 125 dhe 126).

27. Në parantezë shprehim vlerësimin për zhvillimin që sjell ligji për modernizimin e veprimtarisë noteriale nëpërmjet përdorimit të sistemeve elektronike, të cilat, në parim, kur zbatohen brenda kornizave ligjore, kanë efekte pozitive në rritjen e efektivitetit të punës së përditshme të noterëve dhe në përmirësimin e transparencës. Në këtë këndvështrim, detyra e

legjislatorit është krijimi i rregullave ligjore dhe përcaktimi i standardeve për mënyrën se si duhen krijuar dhe implementuar sistemet elektronike, të cilat duhet të bëhen në përputhje me detyrimet kushtetuese për respektimin e të drejtave të qytetarëve të cilëve u përpunohen të dhënat, në veçanti, garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

28. Ligji nr. 110/2018 nuk e ka konceptuar sistemin elektronik të DHKN-së si bazë të dhënash shtetërore, por si një arkiv aktesh noteriale, ku përfshihen edhe akte që përmbajnë të dhëna personale, madje edhe të dhëna sensitive (siç është rasti i testamentit), përpunimi i të cilave duhet të bëhet vetëm nëse qytetari ka dhënë pëlqimin e tij. Në këtë kuptim, ndërlidhja e këtij sistemi me regjistrat e tjerë publikë duhet të mbajë në konsideratë kërkesat minimale të sigurisë në rastin e transmetimit dhe marrjes së të dhënave të të gjithë qytetarëve që kryejnë veprime noteriale. Për këtë shkak, rregullat për ndërlidhjen duhet të garantojnë sigurinë e të dhënave personale që mbart sistemi elektronik.

29. Kjo pasiguri shtohet nëse analizohet kontrata e lidhur midis DHKN-së dhe shoqërisë private ofruese të shërbimit, për ngritjen dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi, sipas së cilës të gjitha të dhënat personale të qytetarëve (në aktet e përpiluara nga noterët ose të tërhequra nga noterët në regjistrat e tjerë publikë) do të jenë në trajtim dhe ruajtje nga shoqëria private dhe pronësia e sistemit elektronik do t'i kalojë DHKN-së vetëm pas një afati prej 144 muajsh. Kjo do të thotë se sistemi elektronik dhe bashkë me të edhe të gjitha të dhënat e marra, mbeten për një periudhë prej 144 muajsh, në pronësi të një shoqërie private, që nuk provon se kryen një funksion publik.

30. Në shtesë të këtij argumenti, mbetet shqetësues rreziku i mungesës së kontrollit në përpunimin e të dhënave personale, nisur edhe nga fakti se kontrata ndërmjet DHKN-së me shoqërinë ofruese të shërbimit për krijimin e sistemit NISA është lidhur në datën 18.4.2019, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 110/2018 dhe se në kushtet paraprake të kontratës, shkronja “B”, shënohet se DHKN *“ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10325/2010 dhe ka regjistruar në datën 21.12.2017 si databazë shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit bazën e të dhënave NISA”*. Pra, sikurse konstatohet, sistemi elektronik është regjistruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 110/2018, kohë në të cilën vepronte ligji nr. 7829/1994. Ky i fundit nuk i njihet ushtrimin e një kompetence të tillë DHKN-së, por ngarkonte Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Drejtësisë si autoritete që vepronin për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore (neni 71), detyrim i materializuar me nxjerrjen e VKM-së nr. 304, datë 21.5.2014 *“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)”*. Nga ana tjetër, kjo parregullsi rëndohet edhe më tej nga fakti se VKM-ja nr. 1045/2020, ndonëse është miratuar në datën 15.1.2020, është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 4.2.2021, pra pas një viti. Këto fakte ngrenë dyshime serioze, së pari, për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe, së dyti, nëse përpunimi i të dhënave ka respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore, në veçanti atë të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas nenit 35 të Kushtetutës.

31. Në vijim të argumentit të mësipërm, konstatohet se në VKM-në nr. 1045/2020 mungojnë rregulla që sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave sensitive të qytetarit, siç mund të jenë informacionet që kanë të bëjnë me origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar, dënimin penal, shëndetin dhe jetën seksuale, të cilat mund të rezultojnë gjatë hartimit të akteve noteriale dhe aksesit ndaj të cilave vihet në diskutim për shkak të ndërveprimit të sistemit NISA me regjistrat e tjerë publikë. Këtu bie në sy se VKM-ja shprehet se në rastin e komunikimit/transmetimit të të dhënave të qytetarëve me dhe nga të gjithë regjistrat kombëtarë, me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit, kryhet pa asnjë marrëveshje paraprake (pikat 1-7), ndërkohë që një parashikim i ndryshëm përcaktohet në pikën 8 të këtij akti ku trajtohet ndërlidhja me sistemet informatike të sistemit bankar, si dhe të agjencive të tjera shtetërore/publike ose private. Pikërisht për këtë veprimtari, VKM-ja parashikon si parakusht lidhjen e një marrëveshjeje ndërmjet DHKN-së dhe subjekteve administruuese të këtyre të dhënave (si në rastin me bankat e nivelit të dytë), duke sjellë në këtë mënyrë një trajtim të ndryshëm në ofrimin e garancive ndaj të dhënave personale të qytetarëve, në fusha të njëjta të veprimtarisë noteriale.

32. Në shtesë të sa më sipër, ne nuk jemi dakord me vlerësimin e shumicës që pretendimi i kërkuësës së VKM-ja nr. 1045/2020 bie ndesh me ligjin nr. 10325/2010, në thelb, argumentet lidhen me përplasjen ndërmjet akteve nënligjore dhe dispozitave të tjera ligjore, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafin nr. 131 të vendimit*). Është e vërtetë që në pamje të parë, situata e parashtruar duket si konflikt normash, por nga analiza e kësaj çështjeje konstatohet paqartësi në parashikimet e VKM-së nr. 1045/2020 në raport me parashikimet e ligjeve, në referim të garancive që ofron neni 35 i Kushtetutës.

33. Ky vlerësim bazohet në faktin se VKM-ja nr. 1045/2020 e ka trajtuar sistemin elektronik NISA si bazë të të dhënave shtetërore (pika 9), duke kapërcyer në këtë mënyrë autorizimin ligjor të nenit 96 të ligjit nr. 110/2018, sipas të cilit sistemi elektronik i DHKN-së vetëm ndërlidhet me bazat e të dhënave shtetërore për qëllime të qasjes dhe aplikimit për informacion të noterit, të nevojshëm për përpilimin e akteve noteriale.

34. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, konstatohet se VKM-ja, në shtesë të parashikimeve ligjore, në tekstin e saj i referohet konceptit të ndërveprimit, pra të shkëmbimit të të dhënave midis regjistrave elektronikë publikë nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, duke tejkaluar në këtë mënyrë konceptin e qasjes për qëllime aplikimi të noterëve, që përmban neni 96 i ligjit nr. 110/2018.

35. Për këtë arsye është e rëndësishme të theksohet se VKM-ja nr. 1045/2020 krijon paqartësi në raport me parashikimet ligjore, pra nëse sistemi NISA mund të konsiderohet bazë e të dhënave shtetërore dhe cilat janë garancitë e sigurisë së përdorimit me efektivitet të të dhënave personale që ai mbart për interesa dhe shërbime publike. Në këtë drejtim, vihet re se në bazën ligjore të përdorur për miratimin e VKM-së nuk është përfshirë asnjë dispozitë e ligjit për bazat e të dhënave shtetërore. Në vijim, nga shqyrtimi i përmbajtjes së VKM-së, si dhe referuar prapësimeve të subjekteve të interesuara, është e paqartë nëse sistemi NISA të jetë krijuar për të plotësuar vetëm kërkesat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të vetë DHKN-së, çka do ta përjashtonte atë nga fusha e zbatimit të ligjit nr. 10325/2010 (neni 2, pika 2). VKM-ja përmban përcaktime për sa i përket dhënësit/dhënësve të informacionit, ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe nivelin e aksesimit, elemente këto që duhet t'i ketë të përcaktuara akti i krijimit të një baze të dhënash shtetërore (neni 4 i ligjit nr. 10325/2010), të cilat janë të paplota, pasi nuk rregullohen elementet e tjera (për ilustrim, mungojnë rregullat për përcaktimin e të dhënave parësore dhe dytësore). Nëse sistemi NISA është bazë e të dhënave shtetërore, atëherë rregullimi dhe koordinimi i këtij sistemi do të duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë së Autoritetit Rregullator Koordinues (në rastin konkret AKSHI-t), kompetencat ligjore të të cilit (neni 10 i ligjit nr. 10325/2010) konfliktohen me kompetencën e DHKN-së për krijimin, administrimin, përmirësimin dhe përditësimin në vazhdimësi të sistemit NISA (neni 81, shkronja "dh", të ligjit nr. 110/2018).

36. Një arsye tjetër që e shton paqartësinë është mbivendosja e dy sistemeve elektronike paralele, RNSH-ja dhe NISA, gjë e cila sjell pasiguri juridike. Pasiguria bëhet më e evidente edhe për shkak të mënyrës së krijimit të sistemit NISA (*shih paragrafët nr. 29 dhe nr. 30 të këtij mendimi pakice*) dhe e drejta e aksesit që i është dhënë Ministrisë së Drejtësisë në këtë sistem për qëllime kontrolli nga VKM-ja (pika 12). Paqartësia e mbivendosjes së sistemeve konfirmohet edhe nga shpjegimet e DHKN-së në seancë plenare, e cila e koncepton sistemin NISA në funksion të kompetencave të Ministrisë së Drejtësisë dhe se VKM-ja nr. 1045/2020 e vendos këtë ministri në rolin e monitoruesit/inspektuesit të shërbimit noterial (*shih paragrafin nr. 12.3.1. të vendimit*).

37. Mbi bazën e këtij arsyetimi, ne, gjyqtaret në pakicë, çmojmë se problemi kushtetues i VKM-së nr. 1045/2020 lidhet me paqartësinë e rregullave për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve elektronike që zhvillohen dhe përdoren, gjë e cila krijon pasiguri në mbrojtjen efektive të këtyre të dhënave personale. Ky problem kushtetues duhet vlerësuar edhe në kontekstin shoqëror të Shqipërisë, në të cilin ka nevojë të shtuar për të pasur kujdes ndaj aksesit dhe përpunimit të të dhënave personale, me qëllim jo vetëm mbrojtjen e tyre, por edhe eliminimin e çdo keqpërdorimi të të dhënave. Për këtë qëllim, mjafton t'i referohemi Raportit të

Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë të datës 19.10.2021, në të cilin pasqyrohet shqetësimi për rrjedhjen e të dhënave personale të qytetarëve lidhur me preferencat politike të tyre, duke i dhënë Shqipërisë rekomandimin për vitin 2021 për përmirësimin e sigurisë dhe të kufizimit të aksesit, dhe përdorimit të të dhënave personale të administruara në bazat e të dhënave shtetërore⁵. Në të njëjtën linjë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare të 25 prillit 2021, shprehet se “*Shqipëria duhet të garantojë sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve. Institucionet përkatëse duhet të betojnë dhe të sanksionojnë plotësisht çdo shkelje që ndikon në besimin e publikut në procesin zgjedhor.*”⁶

38. Si përfundim, për të gjitha argumentet e parashtruara më lart, vlerësojmë se subjektet e interesuara dështuan të justifikojnë në mënyrë bindëse në gjykim se VKM-ja nr. 1045/2020 plotëson standardet e sigurisë juridike në drejtim të garantimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Për rrjedhojë, kjo VKM bie ndesh me nenet 4 dhe 35 të Kushtetutës dhe, si e tillë, duhet të ishte shfuqizuar.

Anëtar: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të kërkesës së paraqitur nga shoqata “Unioni i Noterëve Shqiptarë” (*kërkuesja*), me të cilën është kërkuar shfuqizimi i disa dispozitave të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” (*ligji nr. 110/2018*) dhe i VKM-së nr. 1045, datë 15.1.2020 “Për mënyrën e ndërlidhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave” (*VKM nr. 1045/2020*), jam pjesërisht kundër qëndrimit të shumicës. Qëndrimi im kundër lidhet me një prej pretendimeve të kërkuësës, për të cilin vlerësoj se është i bazuar dhe duhet pranuar, e më konkretisht pretendimi për antikushtetueshmërinë e pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018, i cili duhet shfuqizuar tërësisht, bazuar në argumentet e mëposhtme që mbështesin këtë qëndrim.

2. Kërkuesja ka pretenduar se parashikimi i nenit 10, pika 6, të ligjit nr. 110/2018 cenon parimin për të mos kryer një punë të detyruar, të parashikuar në nenin 26 të Kushtetutës dhe nenin 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), pasi e detyron noterin e emëruar në një bashki të kryejë për katër ditë shërbim në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor, në të cilën nuk vepron asnjë zyrë noteriale. Gjithashtu, ky parashikim bie ndesh edhe me lirinë e veprimtarisë private dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës, të parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës. Në këtë rast, të paktën duhet të merret edhe pëlqimi i noterit.

3. Subjektet e interesuara, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se caktimi i noterit në një bashki tjetër, sipas pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018, nuk nënkupton kryerjen e një pune të detyruar, nuk cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën për të zgjedhur vendin e punës, në kushtet kur kjo veprimtari ka disa karakteristika thelbësore, që e bëjnë atë publike nga karakteri dhe rëndësia.

4. Në të njëjtën linjë me shumicën, edhe unë i qëndroj konstatimit se në pamje të parë përmbajtja e pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018, e parë me parashikimin e nenit 26 të këtij ligji, duket që krijon punë të detyruar për noterin, sepse nëse ai nuk pranon të kryejë shërbimin, sjellja e tij konsiderohet si shkelje e ligjit, që mund të vlerësohet si shkelje disiplinore. Për më tepër vlen të theksohet se dispozita gjen zbatim edhe ndaj atyre noterëve që kanë marrë licencën për ushtrimin e profesionit të noterit, përpara hyrjes në fuqi të ligjit që përcakton këtë rregull (shih paragrafin nr. 56 të vendimit).

⁵ Për më shumë shih: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en, faqe 27.

⁶ Për më shumë shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>, rekomandimi nr. 4, faqe 31.

5. Fillimisht, vlerësoj se noteri në kuadër të ditëve mujore të parashikuara nga ligji nr. 110/2018 për kryerjen e shërbimit pranë një njësie tjetër bashkiake me mungesë të zyrës noteriale, është në pamundësi të bëjë një zgjedhje të lirë të profesionit, në drejtim të vendit për të punuar. Ky parashikim i jep noterit një pasiguri në kryerjen e profesionit të tij në mënyrë të lirë e brenda njësisë bashkiake për të cilën i është dhënë licenca e ushtrimit të profesionit. Noteri, i urdhëruar të kryejë veprimtarinë në një njësi tjetër bashkiake, do të privohej nga të ardhurat që do të përfitonte pranë zyrës së tij me klientelën e tij të përhershme. Ndaj dhe parashikimi i ri i vendosur nga dispozita në fjalë merr tiparet e një pune të detyruar, e cila sjell ndërhyrje në të drejtat e parashikuara në nenin 49 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky parashikim ligjor nuk ka se si të shkojë në interes të vetë noterit dhe mundësia që ai të rrisë të ardhurat dhe të nxisë konkurrencën mes noterëve mbetet hipotetike dhe pa baza besueshmërie.

6. Ajo që më ndan me shumicën lidhet me vlerësimin nëse kjo dispozitë respekton kriteret e përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës, sikurse kriteri i kufizimit me ligj, kriteri i ekzistencës së interesit publik dhe kriteri i proporcionalitetit, që është dhe testi i cili duhet të gjejë zbatim për çdo ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore të individit.

7. Shumica ka konkluduar se pretendimi i kërkuar për antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite nuk është i bazuar, pasi parashikimi i pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 përmbush kriteret e përcaktuar në nenin 17 të Kushtetutës. Sipas shumicës, detyrimi për parashikimin e ndërhyrjeve me ligj në kuptimin formal rezulton të jetë respektuar, pasi ndërhyrja është bërë nëpërmjet një ligji të miratuar nga Kuvendi, konkretisht me ligjin nr. 110/2018, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim; ka një interes publik që lidhet me garantimin e një veprimtarie publike (ajo e noterit), i cili e justifikon ndërhyrjen; dhe ligji ka përcaktuar edhe disa garanci që duhet të përmbushen në rast të detyrimit të ushtrimit të veprimtarisë në një bashki tjetër, si: karakteri përjashtimor i këtij detyrimi, i cili zbatohet vetëm kur verifikohet kushti se në një bashki të caktuar nuk vepron asnjë zyrë noteriale; kohëzgjatja relativisht e shkurtër e këtij detyrimi për noterin “gjer në katër ditë shërbim në muaj”; distanca e afërt gjeografike e lëvizjes së noterit “në një bashki brenda kufijve të rrethit gjyqësor”; garantimi i infrastrukturës së nevojshme dhe i shpenzimeve, të cilat nuk rëndojnë mbi noterin që ofron këtë lloj shërbimi, si dhe procedura e nxjerrjes së urdhrit nga ministri i Drejtësisë, pas marrjes së mendimit të Dhomës Kombëtare të Noterisë (DHKN) (shih paragrafët nr. 58–63 të vendimit).

8. Në vlerësimin tim të çështjes, çmoj se formulimi i pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 bie ndesh me të drejtën për të ushtruar veprimtarinë e parashikuar në nenin 26 të Kushtetutës dhe me ushtrimin e lirisë së zgjedhjes së profesionit dhe vendit të punës, të parashikuar në nenin 49 të saj, kjo, pasi asnjë individ, përfshirë edhe noterin, nuk mund të detyrohet të ushtrojë detyrën aty ku caktohet në mënyrë arbitrare qoftë kjo edhe me përcaktim nga një autoritet shtetëror sikurse ministri i Drejtësisë.

9. Në analizë të dispozitave ligjore në fuqi, të aplikuashme në ushtrimin e lirisë së zgjedhjes së punës, theksoj se neni 26 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve. Po kështu, neni 49 i Kushtetutës parashikon se secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të tij profesional. Këto parashikime kushtetuese vijnë në të njëjtën qasje me nenin 4 të KEDNJ-së që parashikon se askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në jurisprudencën e saj ka marrë kryesisht në konsideratë tërësinë e rrethanave të çështjes, në dritën e objektivave që janë në themel të nenit 4, për të përcaktuar nëse shërbimi i kërkuar përfshihet në ndalimi i “punës së detyruar ose të detyrueshme” (shih vendimet *Van der Musselle kundër Belgjikës*, 1983 § 37; *Bucha kundër Sllovakisë*, 2011). Standardet e përpunuara nga GJEDNJ-ja për të vlerësuar se çfarë mund të paraqitet si normale, kur është fjala për detyrat që u takojnë pjesëtarëve të një profesioni të

caktuar, marrin parasysh disa pika, konkretisht nëse shërbimet e kryera dalin jashtë suazës së veprimtarive profesionale normale të personit në fjalë, nëse këto shërbime janë të shpërblyera ose jo, ose nëse ato përmbajnë një formë tjetër kompensimi, nëse detyrimi është mbi bazë pikëpamjeje të solidaritetit shoqëror dhe nëse barra e ngarkuar është e shpërpjesëtuar (*shih vendimet Graziani-Weiss kundër Austrisë, 2011 § 38; Mihal kundër Sllovakisë, 2011 § 64*).

10. Duke iu kthyer rastit konkret, vlerësoj se urdhërimi nga ministri i Drejtësisë që një noter i emëruar sipas vetë urdhrit të tij, në një bashki të caktuar, të kryejë deri në katër ditë shërbim në muaj në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor, në të cilën nuk vepron asnjë zyrë noteriale, në interpretim edhe për sa u pasqyrua më lart, qoftë të nenit 4 të KEDNJ-së ose të jurisprudencës së GJEDNJ-së, përbën shkelje të të drejtave të noterit për të ushtruar i qetë veprimtarinë e tij. Ky parashikim ligjor bëhet akoma edhe më i ashpër duke e shtrirë natyrën e zbatimit të tij deri në abuzivizëm, nëse merret në konsideratë fakti që subjekti ndaj të cilit jepet urdhërimi, pra noteri, nuk ka asnjë mundësi paraprake të dhënies së pëlqimit të tij ndaj një urdhri të tillë. Kështu, parashikimi ligjor mjaftohet vetëm me marrjen e një mendimi nga DHKN-ja nga ana e ministrit, edhe ky jo i detyrueshëm për të, çka lehtësisht e transformon urdhërimin e ministrit të Drejtësisë në një veprim të pakontrolluar nga askush.

11. Në vijim, theksoj që parashikimi se ministri i Drejtësisë urdhëron kryerjen e shërbimit, pas marrjes së mendimit të DHKN-së, nuk ofron garancitë e nevojshme që kjo prerogativë e tij të mos të kthehet në një mjet abuzimi ose shpërdorimi në dëm të interesave të një noterit të caktuar. Cenimi i interesave të noterit rëndohet edhe më tepër nëse ky parashikim ligjor vlerësohet i ndërthurur me përcaktimin e shkeljeve disiplinore të parashikuara në nenin 26 të ligjit nr. 110/2018, pasi kundërshtimi i noterit për të kryer shërbimin konsiderohet shkelje e detyrimeve ligjore të përcaktuara nga ligji.

12. Për sa më sipër, në përmbajtje të dispozitës ligjore nuk përcaktohen kritere ose rregullime mbi bazën e të cilave ministri i Drejtësisë do të përzgjedhë noterin që do të kryejë shërbimin në kushtet kur brenda së njëjtës bashki janë emëruar dy ose më shumë noterë, çka përforcon mungesën e garancive që ofron ky përcaktim ligjor në interes të noterit.

13. Së fundmi, vlerësoj se ky parashikim ligjor sjell paqartësi dhe problematika për noterin e licencuar nën regjimin e kuadrit ligjor të mëparshëm, në të cilin një parashikim i tillë nuk ka qenë i normuar, çka e vendos atë në situatën e pasigurisë, në kushtet kur në kohën që ka vendosur të ushtrojë këtë veprimtari nuk ka qenë në dijeni dhe nuk ka shprehur gatishmërinë për ta ushtruar atë edhe në situatën e ofrimit të shërbimit jashtë bashkisë ku është emëruar.

14. Mbi bazën e këtyre argumenteve, vlerësoj se pika 6 e nenit 10 të ligjit nr. 110/2018 duhet të shfuqizohet tërësisht, pasi cenon lirinë e veprimtarisë së noterit.

Anëtar: Sonila Bejtja